



RAPORT

Përmbushja e premtimeve të Agim Aliut

Dhjetor, 2022

RAPORT I VLERËSIMIT:

Përmbushja e premtimeve të Agim Aliut

Autor: Valmir Ilazi

Redaktor: Qëndrim Arifi

Iniciativa për Progres – INPO

Programi për Qeverisje të Mirë

© Iniciativa për Progres – INPO

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativa për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e organizatës INPO dhe nuk pasqyron qëndrimet e Rockefeller Brothers Fund.



Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Përmbajtja

Paraqitja tabelare.....	4
Paraqitja grafike.....	4
Kuptimi i shprehjeve të përdorura.....	5
Rreth INPO-së.....	6
Hyrje.....	7
Ecuria e përmbushjes së premtimeve të Agim Aliut.....	8
FUSHA 1. GJELBËRIMI.....	10
FUSHA 2. ARSIMI.....	13
FUSHA 3. ADMINISTRATË PUBLIKE, FINANCA DHE BUXHETI.....	19
FUSHA 4. INFRASTRUKTURA.....	21
Fusha 4.1. Mbështetja e projekteve nga fusha e infrastrukturës në partneritet me Qeverinë, Bashkimin Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë.....	23
FUSHA 5. SHËNDETËSI.....	24
FUSHA 6. URBANIZIMI DHE MBROJTJE MJEDISORE.....	27
FUSHA 7. KULTURË, RINI DHE SPORT.....	29
FUSHA 8. ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM.....	33
FUSHA 9. SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCA.....	36
FUSHA 10. BUJQËSI DHE PYLLTARI.....	38
Pasqyrë e realizimit të 103 premtimeve.....	44
Projektet kapitale brenda 103 premtimeve.....	45
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe projektet kapitale të parapara të cilat ndërlidhen me premtimet e kryetarit të komunës.....	46
Premtimet për të cilat nevojitet zhvillimi i procedurave të prokurimit.....	47
Premtimet të cilat kanë qenë të planifikuara me Plan të Prokurimit për vitin 2022.....	47
Premtimet e inicuaru nëpërmjet procedurave të prokurimit gjatë vitit të parë të mandatit qeverisës.....	48
Rekomandime.....	50

Paraqitja tabelare

- Tabela 1: Gjellbërim;
- Tabela 2: Arsimi;
- Tabela 3: Administrata Publike, Financat dhe Buxheti;
- Tabela 4: Infrastruktura dhe mbështetja e projekteve kapitale të Qeverisë, Bashkimit Evropian dhe donatorëve tjerë;
- Tabela 5: Shëndetësi;
- Tabela 6: Urbanizim dhe Mbrojtje Mjedisore;
- Tabela 7: Kulturë, Rini dhe Sport;
- Tabela 8: Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;
- Tabela 9: Shërbimet Publike dhe Emergjenca;
- Tabela 10: Bujqësi dhe Pylltari;
- Tabela 11: Pasqyrë e realizimit të 103 premtimeve;
- Tabela 12: Projektet kapitale brenda 103 premtimeve;
- Tabela 13: Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe projektet kapitale të parapara të cilat ndërlihen me premtimet e kryetarit të komunës;

Paraqitja grafike

- Grafika 1: Ecuria e përmbushjes së premtimeve të Agim Aliut
- Grafika 2: Ecuria e përmbushjes së premtimeve sipas fushave
- Grafika 3: Paraqitja e premtimeve të cilat realizohen përmes procedurave të prokurimit
- Grafika 4: Paraqitja e premtimeve të cilat kanë qenë të planifikuara me Plan të Prokurimit vitin 2022;
- Grafika 5: Premtimet e inicuar përmes procedurave të prokurimit

Kuptimi i shprehjeve të përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë raport e kanë kuptimin ashtu siç përcaktohet më poshtë:

“Premtim” e ka kuptimin e zotimit për të kryer diçka, ndonjë punë, në këtë rast zotimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt për kryerjen e punëve gjatë mandatit qeverisës katër vjeçar.

“Rezultatet” e ka kuptimin e asaj që çfarë rezultate deri në këtë kohë janë arritur në kuadër të përmbushjes së premtimit të caktuar, qofshin ato edhe minimale.

“Fusha” tregon fushën e caktuar, përkatësisht premtimin, në cilën nga dhjetë fushat bënë pjesë sepse njëqind e tre (103) premtimet janë të ndara në dhjetë fusha dhe në këtë raport gjinden në bazë të numrin rendor: Fusha 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10.

“Numri i premtimeve” ka kuptimin për numrin e përgjithshëm të premtimeve për secilën fushë dhe numrin e përgjithshëm të premtimeve për të gjitha fushat, që në këtë rast janë gjithsej njëqind e tre (103).

“Premtimet e realizuara plotësisht” do të thotë që premtimi është realizuar ashtu siç është premtuar, respektivisht nuk kërkohet ndonjë punë shtesë për ta kompletuar premtimin sepse është përmbushur 100%.

“Premtimet gjysmë të realizuara” e ka kuptimin e asaj që në bazë të punëve që janë kryer mund të vijmë në përfundim se gjysma e punëve kanë përfunduar, pra premtimi është realizuar jo më shumë se 50%.

“Premtimet e filluara” me këtë përkufizim kuptojmë që për premtimin në fjalë është marrë ndonjë veprim në kuadër të realizimit të premtimit.

“Premtimet të pa filluara” e ka kuptimin e asaj që komuna nuk ka marrë ndonjë veprim konkret që do të kontribuonte në fillimin e realizimit të premtimit të caktuar, pra nuk ka asnjë sinjal që është zhvilluar diçka në atë drejtim.

Rreth INPO-së

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni i Organizatës INPO është për institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës, ndërsa INPO për mision ka promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizmit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur.

Vizioni dhe misioni i Organizatës INPO përmbushen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të Organizatës:

(i) Programi për Qeverisje të Mirë, dhe

(ii) Programi për Zhvillim Demokratik.

Ky dokument është produkt i Programit për Qeverisje të Mirë, program i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në institucionet publike.

Hyrje

Kryetari i Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu, gjatë fushatës zgjedhore ka premtuar gjithsej njëqind e tre (103) premtime të cilat i ka ndarë në dhjetë fusha: (i) Gjelbërim, (ii) Arsim, (iii) Administratë Publike, Financat dhe Buxheti, (iv) Infrastrukturë, (v) Shëndetësi, (vi) Urbanizim dhe Mbrojtje Mjedisore, (vii) Kulturë, Rini dhe Sport, (viii) Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, (ix) Shërbimet Publike dhe Emergjencë (x) Bujqësi dhe Pylltari.

Qëllimi i këtij raporti është që të jap një pasqyrë se sa nga këto premtime i ka përmbushur Kryetari i Komunës së Ferizajt, meqë ka kaluar më shumë se një vit që kur e ka marrë mandatin, pastaj për sa prej tyre është ndërmarrë ndonjë veprim i caktuar drejt përmbushjes dhe sa premtime ende nuk kanë filluar të realizohen. Gjithashtu, qëllimi i këtij raporti konsiston edhe në argumentimin e veprimeve që janë ndërmarrë në kuadër të realizimit të premtimit si dhe efektet praktike të veprimeve në fjalë.

Brenda këtij raporti mund të gjeni secilin premtim të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, pavarësisht nëse është realizuar plotësisht, pjesërisht apo nuk ka filluar fare të realizohet. Nëse ka filluar të realizohet gjithmonë do ta ketë të bashkangjitur secilin hap që është ndërmarrë në atë drejtim. Premtimet janë të renditura sipas fushave duke filluar nga fusha e parë deri tek fusha e dhjetë. Për secilën fushë në fund është e bashkangjitur tabela e cila tregon për numrin e premtimeve të realizuara, gjysmë të realizuara, të filluara apo të pa filluara, përkitazi me atë fushë. Në pjesën e fundit janë dhënë disa pasqyrime të sakta dhe të qarta lidhur me të gjitha premtimet, të cilat janë të inkorporuara në një tabelë të veçantë.

Raporti përfundon me paraqitjen grafike të premtimeve të cilat duhet të realizohen përmes procedurave të prokurimit, lidhshmërisë së premtimeve me Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022 dhe premtimet e inicuar përmes platformës së prokurimit gjatë vitit të parë të mandatit qeverisës. Raporti përfshinë periudhën kohore nga data 01 dhjetor 2021 deri më 01 dhjetor 2022


Gjatë punimit të këtij raporti është përdorur metoda e hulumtimit dytësor, metoda e analizës dhe metoda krahasimore.

Ecuria e përmbushjes së premtimeve të Agim Aliut

INPO ka monitoruar secilin veprim të qeverisë së kryetarit Agim Aliu, në Ferizaj, për të vlerësuar ecurinë e përmbushjes së secilit premtim. Periudha e monitorimit të veprimeve të ndërmarra për përmbushjen e premtimeve është 01 dhjetor 2021 deri me 01 dhjetor 2022. Rezultatet e monitorimit tregojnë se:


Kryetari i komunës së Ferizajt nga njëqind e tre (103) premtimet ka arritur që plotësisht t'i përmbushë vetëm katër (4) dhe gjysmë të përmbushura pesë (5). Ka filluar ti realizoj tridhjetë e shtatë (37) ndërkaq pesëdhjetë e shtatë (57) premtime akoma nuk kanë filluar ose nuk ka ndonjë iniciativë për fillimin e realizimit të tyre.

Grafika 1: Ecuria e përmbushjes së premtimeve



Fushat të cilat plotësisht nuk është realizuar asnjë premtim, pra zero (0) premtime të realizuara plotësisht janë fushat: 1. Gjelbërimi, 2. Arsimi, 3. Administratë Publike, Financa dhe Buxheti, 4. Infrastruktura, 5. Shëndetësia, 6. Urbanizëm dhe Mbrojtje Mjedisore, 8. Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi. Fusha me më së shumti realizime është fusha shtatë (7) “Kulturë, Rini dhe Sport”, ku nga shtatë (7) premtime, dy (2) prej tyre janë realizuar plotësisht. Me nga një (1) premtim të realizuar janë fusha nëntë (9) dhe dhjetë (10).

Grafika 2: Ecuria e përmbushjes së premtimeve sipas fushave



Nga njëqind e tre (103) premtime të dhëna gjatë fushatës, pesëdhjetë e një (51) janë projekte kapitale. Premtimet e kryetarit të Komunës së Ferizajt për mandatin qeverisës 2021-2025 nuk përkojnë shumë me punët që janë kryer, që nga betimi i tij si Kryetar i Komunës, të analizuara nga data 01 dhjetor 2021 deri më 01 dhjetor 2022. Nga njëqind e tre (103) premtimet, vetëm gjashtëdhjetë e tetë (68) realizohen përmes procedurave të prokurimit ose të tenderimit. Nga gjashtëdhjetë e tetë (68) premtimet të cilat duhet të realizohen përmes procedurave të prokurimit ose të tenderimit njëzetë e katër (24) janë të përfshira paraprakisht në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022, ndërsa tridhjetë e gjashtë (36) nuk janë të përfshira, dhe pjesërisht të përfshira janë vetëm tetë (8).

Nga njëqind e tre (103) premtimet, vetëm njëzetë e shtatë (27) prej tyre janë të inciuara në platformën e-Prokurim, që nga fillimi i mandatit dhjetor 2021-2025. Nga pesëdhjetë e një (51) projekte kapitale të premtuara, vetëm tridhjet (30) janë të përfshira si Investime kapitale të Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

FUSHA I. GJELBËRIMI

Në kuadër të fushës së gjelbërimit, Kryetari i Komunës së Ferizajt kishte premtuar që në katër vitet e ardhshme do të angazhohet fuqishëm për politika të gjelbërta përkatësisht lidhjen e zhvillimit me investime në gjelbrim të qytetit. Në këtë fushë janë evidentuar gjithsej nëntë (9) premtime ku do të analizohen premtimet dhe do të shihet sa është angazhuar për politika të gjelbërta gjatë një vjeçarit të parë të mandatit të tij z. Aliu.

Premtimi 1: Park tek "Gjon Serreç", duke përfshirë si: Parking nëntokësor, park, kënd të lodrave, hapësirë për të moshuarit dhe zhvillimin sportive rekretative.

Rezultatet: Lidhur me këtë premtim, Komuna e Ferizajt në mandatin e kaluar e kishte inicuar aktivitetin për studimin e fizibilitetit, por të cilin pas procedurave të tejzgatura të prokurimit, të njëjtin e anulon në vitin 2022, me arsyetimin se nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës. Në fakt duke theksuar se *"Duke pasur parasyshë që kjo lëndë është në OSHP që një kohë të gjatë që nga muaji maj i vitit 2021 dhe që nga ajo kohë nuk kemi ende një bord për shqyrtimin e saj, njësia kërkuese respektivisht drejtoria e Urbanizmit nuk ka më interesim për vazhdimin e kësaj procedure, andaj rekomandon anulimin e procedurës"*.¹ INPO e vlerëson këtë premtim të pa filluar, ngase ende nuk është filluar me procedurat e prokurimit për ndërtimin e këtij parku.

Premtimi 2. Liqeni artificial.

Rezultatet: Projekti ka mbetur peng i zhvendosjes së *"Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare"* afër Stacionit të Ri të Autobusëve, sepse premtimi është që saktësishtë në këtë pjesë të caktuar të qytetit të ndërtohet një park i cili përfshinë tri hapësira kryesore të parkut, si: Liqen, kënd të lodrave dhe amfiteatër. Procedura e prokurimit e inicuar ishte anuluar nga zyra e prokurimit me datë 12.09.2022.² Aktiviteti është ri-tenderuar një muaj më vonë, konkretisht me datë

¹ Shih aktivitetin e prokurimit: Fizibiliteti për krijimin e parkut - sheshit në oborrin e shkollës Gjon Serreçi duke i trajtuar gjithashtu edhe ndërtimin e parkingjeve nëntokësore, dokumenti B10 Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, datë 18.03.2022 <https://cutt.ly/wMDtStU>

² Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj <https://cutt.ly/FMDt4EI>

04.10.2022.³ Ky projekt mund të bëhet vetëm pas zhvendosjes së spitalit andaj INPO e konsideron këtë premtim të pa filluar.

Premtimi 3. Zona të gjelbëruara në qytet sipas konceptit “Pocket Park”. Parku tek ish stacioni i autobusëve të shndërrohet në park i cili u ofron banorëve të zonës natyrën, dhe Parku në Nekodim.⁴

Rezultatet: Komuna ka inicuar procedurën e prokurimit me titull “Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregulimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara”, me vlerë 500.000 euro dhe me kohëzgjatje prej (12) dymbëdhjetë muaj.⁵ Komuna ka paraparë zona të gjelbëruara në qytet sipas konceptit “Pocket Park” në shtyllën e tretë (3) Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij tek Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, tutje KAB.⁶ Këtë premtim INPO e konsideron si të filluar.

Premtimi 4. Rikonstruktimi i Parkut të "Lirisë".

Rezultatet: Në Planin e Prokurimit, komuna ka paraparë “Zgjerimi dhe rregullimi i parkut Liria-projekt tre vjeçar” me vlerë 260.000 euro.⁷ Me datë 28.04.2022, komuna ka bërë përzgjedhjen e fituesve të Konkursit të Projektimit për pranimin e propozimeve të zgjidhjeve ideore të projektit.⁸ Lidhur me këtë deri në datën e hulumtimit, nuk ka ndonjë aktivitet të prokurimit të iniciuar, mirëpo pasi hapat fillestar janë arritur këtë premtim INPO e konsideron si të filluar.

Premtimi 5. Pyllëzimi i Kodrës së "Sherretëve", mundësia për sporte rekreative dhe “pika e vrojtimit” (point of view).

Rezultatet: Pyllëzim në aspektin procedural të prokurimit, është i paraparë me Planin e Prokurimit me vlerë 180.000 euro.⁹ Nga kjo shumë 30.000 euro janë ndarë për fazën e hartimit

³ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësis Familjare në Ferizaj <https://cutt.ly/0MDypO4>

⁴ Burimi: Një park shumë i vogël ose një zonë e jashtme për argëtim publik, veçanërisht një shesh urban ose oborr me stola dhe shatërvanë, <https://www.dictionary.com/browse/pocket-park>

⁵ Burimi I: Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregulimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara <https://cutt.ly/mMDynoA> Burimi II: <https://cutt.ly/SMDyUBx> Shih gjithashtu: Lista e investimeve kapitale për vitin 2022 - Numër rendor 27, Numri i Kodit të projektit: 51575.

⁶ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://cutt.ly/gMDyXbG>

⁷ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

⁸ Shih aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projektit - Zgjerimi dhe rregullimi i parkut Liria <https://cutt.ly/qMDy3TF>

⁹ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

të projektit dhe janë iniciuar procedurat e prokurimit për hartimin e projektit, mirëpo deri në datën e hulumtimit nuk ka ndonjë aktivitet të prokurimit të iniciuar, andaj INPO e konsideron këtë premtim si të filluar, sepse janë ndërmarrur hapat fillestar të projektit.¹⁰

Premtimi 6. Parku tek lokacioni i tanishëm i Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastërtia”. Hapësirë prej 53 ari, hapësira për lojë dhe rekreacion.

Rezultatet: Ky premtim është i paraparë me Planin e Prokurimit me vlerë 50.000 euro. Mirëpo sa i përket inicimit të ndërtimit të parkut brenda datës së hulumtimit nuk ka ndonjë aktivitet të prokurimit të iniciuar, andaj ky premtim konsiderohet i pa filluar.¹¹

Premtimi 7. Gjelbërim i kryqëzimeve të rrugëve, hapësirat ‘jo aktive’ të bëhen të gjelbërta.

Rezultatet: Ky premtim është planifikuar me Planin e Prokurimit në vlerë 40.000 euro.¹² Lidhur me këtë komuna ka inicuar aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i nyjeve (udhëkryqeve) në trafik - projekt 24 maj”, ku ndër të tjerash me paramsën e këtij projekti parashihet 5.1) Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e dheut të klasit të parë. 5.2) Furnizimi, transporti, vendosja e barit të fabrikuar (bari të gatshëm). Mund të konstatojmë se komuna ka ndërmarrur veprime për gjelbërimin e kryqëzimeve të rrugëve andaj konsiderohet si premtim i filluar.¹³

Premtimi 8. Hapësira të gjelbërta në fshatra, secili fshat të ketë nga një park, të pyllëzuar dhe me kënd të lojërave për fëmijë.

Rezultatet: Komuna në Plan të Prokurimit ka paraparë “Krijimi i hapësirave të gjelbërta” me vlerë 40.000 euro, megjithatë pa dhënë detaje më shumë e parashikon edhe tek KAB 2023-2025 duke emëruar si “Hapësira të gjelbërta në fshatra” në shtyllën e tretë (3) Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij. Lidhur me këtë Komuna në vitin 2021 ka inicuar aktivitetin për “Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregullimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara” por duke qenë se ky premtim i përket mandatit të kaluar, konsiderojmë se në këtë mandat ende nuk ka inicuar ndonjë aktivitet për “Hapësira

¹⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projektit Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve <https://cutt.ly/PMDupgd> Shih gjithashtu: Lista e investimeve kapitale për vitin 2022 Numër rendor: 35, Numri i Kodit të projektit: 51561.

¹¹ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

¹² Po aty.

¹³ Shih aktivitetin e prokurimit: Rregullimi i nyjeve (udhëkryqeve) në trafik - projekt 24 maj <https://cutt.ly/AMDumuK>

të gjelbërta në fshatra” ku shprehimisht është cekur që secili fshat do të ketë nga një park, në mungesë të kësaj INPO këtë premtim e konsideron të pa filluar.

Premtimi 9. Rritja e shpenzimeve të mirëmbajtjes së parqeve.

Rezultatet: Komuna ka paraparë dyfishimin e buxhetit për mirëmbajtje të parqeve në shtyllën e tretë (3) Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij tek KAB 2023-2025.¹⁴ Përveç kësaj komuna nuk ka marrë ndonjë veprim konkret që do të kontribuonte në rritje të shpenzimeve të mirëmbajtjes së parqeve dhe fillimin e realizimit të premtimit.

Gjelbërimi				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
9	0	0	4	5

Tabela I: Gjelbërim

FUSHA 2. ARSIMI

Në këtë fushë identifikohen gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) premtime, njëherit arsimit është fusha e dytë me më së shumtë premtime të dhëna gjatë fushatës për madatin qeverisës 2021-2025. Në vijim do të analizohet se sa është angazhuar për arsim cilësor, sa është investuar në infrastrukturë shkollore, për ambiente shkollore moderne gjatë një vjeçarit të parë të mandatit të tij z. Aliu.

Premtimi 10. Përmirësim i infrastrukturës shkollore - paisja e shkollave me material shpenzues, laboratore, do të investohet vazhdimisht në renovim të shkollave dhe ngritje të infrastrukturës.

Rezultatet: Fillimisht komuna sipas Planit të Prokurimit ka planifikuar disa projekte afro 187.000 euro për këtë premtim, të cilët përfshijnë furnizime për nevoja të shkollave, aksesore për biblioteka, renovim të objekteve shkollore dhe rregullim të rrethojave të shkollës.¹⁵ Ndërsa sa i përket aktiviteteve të incuara mund të themi që komuna ka arritur të inicoj në aspektin e tenderimit disa projekte si: Drenimi dhe mirëmbajtja e jashtme e objekteve publike-Shkollat, Ndertimi i aneksit të shkolles së mesme Shaban Hashani, Furnizime me Toner (ngjyra për

¹⁴ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://bit.ly/3X7Nm3T>

¹⁵ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022. i)“Furnizim me shkumesa, tabela dhe material shkollor” numër rendor 43. ii)“Furnizim me perde, tepisona, korniza dhe aksesor për nevoja të Komunës, QKMF-së, QPSsë, bibliotekës, shkollave dhe BZ të Komunës së Ferizajt” numër rendor 47. iii) “Renovimi i objekteve shkollore” numër rendor 11. iiiii). “Renovimi objektit shkollor Besim Rexhepi në Komogllavë (PNF) në Llugaj” numër rendor 58. iiiii) Rregullimi i rrethojave të shkollës, numër rendor 65.

printer), Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj.¹⁶ Andaj bazuar në frymën e investimeve mund të konsiderojmë që është filluar të punohet në këtë drejtim.

Premtimi 11. Zhvillimi i fëmijërisë së hershme përmes konceptit të blerjes së shërbimeve, funksionalizimi i çerdheve në rrugën “Driton Islami” dhe në Greme, ndërsa për vitin 2022 në rrugën “Rexhep Bislimi”.

Rezultatet: Këto çerdhe sipas Komunës kanë mbetur peng i funksionalizimit për shkak të pamundësisë së përfshirjes të puntorëve të rinjë në listë të pagave dhe ndalesës nga Ministria e Arsimit dhe e Financave e cila nuk lejon rritje të numrit të punëtorëve nëpër lista të pagave. Komuna këto çerdhe tenton t’i funksionalizoj në partneritet publiko-privat. INPO lidhur me këtë çështje ka kërkuar sqarime edhe nga Komuna e Ferizajt, të cilët kanë potencuar që “Çerdhet në Greme dhe rrugën ‘Driton Islami’ jemi në proces të funksionalizimit, kurse çerdhja në rrugën ‘Rexhep Bislimi’ do fillojë së shpejti ndërtim i saj pas subvencionimit të kontratave që do bëhet për operatorët ekonomik nga Qeveria e Kosovës përmes ligjit përkatës për mbrojtje nga inflacioni”. Për pasojë, këto çerdhe shpesh herë kanë qenë cak i sulmeve dhe dëmtimeve nga persona të pandërgjegjshëm. Andaj në mungesë të realizimit të këtij premtim, INPO e konsideron këtë premtim si të pa filluar.¹⁷

Premtimi 12. Çerdhe me mbulueshmëri zonale në:

- Babush i Ri - për Babushin e Ri, Cërrnillë, Mirash, Surqinë, Tërrn, Bablak, dhe Prelez i Muhaxherëve;
- Komogllavë - për Komogllavë dhe Gurëz;
- Neredime e Epërme - për Neredime të Poshtme dhe të Epërme, Balaj, Manastirc, Jezerc;
- Talinoc i Muhaxherëve - për Talinoc të Muhaxherëve, Sazli, Softaj, Pojatë, Mirosalë, Rahovicë dhe Papaz;

¹⁶ Drenimi dhe mirembajtja e jashtme e objekteve publike-Shkollat, QKMF-te,AMF-te e tjera <https://bit.ly/3hR0B8Q> Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani <https://bit.ly/3tHrQpe> Furnizim me Toner (ngjyra për printer) <https://bit.ly/3EGcdoc> Punë shtesë-Ndërtimi i sallës së sporteve dhe rregullimi i oborrit në shkollën “Astri Bytyçi” - Ferizaj <https://bit.ly/3gisaYk>

¹⁷ Shih më shumë raportimet nga Kallxo: <https://bit.ly/3gdLRAD> dhe <https://bit.ly/3GsbNml>

- Lloshkobare - për Lloshkobare, Koshare, Dramjak, Slivovë, Kosinë; Dardani - për Bibaj, Fshat i Vjetër, Sojevë, Dardani, Zllatar;
- Lagjen Sherret - shërben dhe për Pleshinë dhe Zaskok.

Rezultatet: Në Planin e Prokurimit për vitin 2022 komuna kishte planifikuar vetëm për ndërtimin e çerdhes për fëmijë në Babush të Ri, Komogllavë, Nerodime dhe në Talinoc të Muhaxherëve.¹⁸ Për çerdhen në fshatin Babush i Ri, e cila parashikohet të ketë mbulueshmëri zonale për Babushin e Ri, Cërrnillë, Mirash, Surqinë, Tërrn, Bablak, dhe Prelez i Muhaxherëve; është nënshkruar kontrata me datë 01.12.2022 me vlerë 98.516,30 euro, kjo kontratë parasheh adaptimin e objektit shkollorë që gjendet në fshatin Babush i Ri në çerdhe.¹⁹ Përkundër që çerdhet tjera si ajo në Komogllavë, Nerodime dhe në Talinoc të Muhaxherëve janë të planifikuara dhe vetëm njëra nga to është e iniciuar, ende nuk kemi ndonjë hap konkret në ndërtimin e këtyre çerdheve të lartpërmendura, brenda kohës së hulumtimit që ky raport përfshinë. INPO konsideron këtë premtim të filluar.

Premtimi 13. Ndërtimi i shkollës fillore në Neredime të Epërme.

Rezultatet: Kjo shkollë nuk ka qenë tek prioritetet e komunës për vitin 2022, kjo dëshmohej edhe me faktin se nuk është përfshirë fare në Planin e Prokurimit. Tutje komuna ka paraparë “Ndërtimi i shkollës së re në Neredime” në KAB 2023-2025 me vlerë 400.000 euro. Në vitin 2020 komuna kishte anuluar pas më shumë se një (1) muaj pas hapjes së ofertave, në të cilin ishin gjithsej tetë (8) ofertues, tenderin për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Neredime. Lidhur me këtë, komuna arrinë të publikoj dy (2) dokumente B10, sipas dokumentit B10 të datës 15.09.2020 arsye e anulimit është “Kërkesë nga DA për anulimin e aktivitetit të prokurimit për arsye të mospërputhjes së projektit me paramsën në nivele që nuk mund të anashkalohen”, ndërsa sipas dokumentit B10 të datës 27.11.2020 arsye e anulimit është “Kërkesë nga DA për anulimin e aktivitetit të prokurimit pas rekomandimit të projektuesit”.²⁰ Komuna gjatë këtij viti qeverisës nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret për ndërtimin e kësaj shkolle, andaj konsiderohet si premtim i pa filluar.²¹

¹⁸ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

¹⁹ Shih kontratën: shorturl.at/FJR28

²⁰ Shih gjithashtu aktivitetin e prokurimit të vitit 2020: shorturl.at/gBEU8

²¹ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://bit.ly/3X7Nm3T>

Premtimi 14. Shkollë për mësim tërëditor dhe me energji të gjelbërt në zonën e re të qytetit afër Stacionit të Ri të autobusëve.

Rezultatet: Shkolla parashihet të bëhet në bashinvestim me Bashkimin Evropian, tutje BE. Lidhur me këtë komuna ka ofruar pronën sipas kërkesës së MASHT-it dhe ka filluar ndërtimi i saj. Ndërlidhur me këtë, komuna në vitin 2017 kishte shpenzuar afro katërdhjetë mijë euro për furnizime me paisje për pilot projektin për mësim tërëditor.²² INPO konsideron këtë premtim të filluar.

Premtimi 15. Ndërtimi i palestrës sportive në oborrin e shkollës “Ganimete Tërbeshi”.

Rezultatet: Komuna e ka paraparë këtë palestër sportive me Planin e Prokurimit në vlerë 120.000 euro.²³ Ky projekt ka qenë i inicuar në mandatin e kaluar por është anuluar në muajin gusht 2021.²⁴ Konkretisht ky aktivitet i prokurimit nuk është Ri-Tenderuar më në platformën e prokurimit dhe si i tillë ky premtim konsiderohet i pa filluar ende në këtë fazë.

Premtimi 16. Investimi në shkolla të reja në Sazli, Pleshinë, Zllatar, Tërrn, Bibaj, dhe Rahovicë, me qëllim të shfrytëzimit të hapësirës së jashtme shkollore.

Rezultatet: Është investuar vetëm në fshatin Tërrn, konkretisht projekti i “Ndërtimi i shkollës filllore-Tërrn”. Kontrata është nënshkruar me Grupin e Operatorëve Ekonomik TALA ENGINEERING SH.P.K.; Termomontimi Sh.P.K, me vlerë 226.411,80 euro.²⁵ Kjo kontratë paraprakisht ka qenë e planifikuar me Planin e Prokurimit por me vlerë 50.000 euro.²⁶ Tutje, premtimi në mënyrë shprehimore përmend investimin në shkolla të reja në Sazli, Pleshinë, Zllatar, Tërrn, Bibaj, dhe Rahovicë. Deri në këtë fazë është arritur të investohet vetëm në një shkollë dhe atë në shkollën e fshatit Tërrn, andaj ky premtim mund të konsiderohet si i filluar.

Premtimi 17. Ndërtimi i 2 objekteve shkollore me koncept tërëditore.

²² Shih aktivitetin e prokurimit: Furnizimi me paisje të shkollave me kabinete të biologjis, kimisë, fizikës, artit figurativ, informatikës, edukatës fizike për shkollat "Riza Matoshi" dhe "Afrim Abazi" për pilot projektin për mësim tërëditor shorturl.at/amoY4

²³ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

²⁴ Komuna përmes dokumentit B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 24.08.2021, ka njoftuar se “Njëri nga Operatorët Ekonomik ka qenë i papërgjegjshëm ndërsa njëri nga operatorët ekonomik ka tejkaluar vlerën e parashikuar të këtij projekti dhe njësisia kërkuese gjegjësisht Drejtoria e Arsimit nuk ka mundur të siguroj mjete shtesë për këtë projekt.” <https://bit.ly/3V40GEw>.

²⁵ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i shkollës filllore - Tërrn - <https://bit.ly/3V87lbn>

²⁶ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

Rezultatet: Komuna komuna ka paraparë “Ndërtimi i dy objekteve të reja shkollore për koncept tërëditor” në shtyllën e pestë (5) Arsimit cilësor, fuqizim i bazës teknike, programore dhe profesioniste tek KAB 2023-2025.²⁷ Sa i përket fillimit të realizimit të premtimit ende nuk është marrur ndonjë hap konkret.

Premtimi 18. Investimi në objekte të reja shkollore, salla sportive, kabinete shkencore dhe kabinete të teknologjisë informative dhe biblioteka. Funkcionalizim të oborreve shkollore.

Rezultatet: Është filluar të investohet në objekte të reja shkollore, konkretisht komuna ka investuar në shkollat: Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani, Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani, Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj.²⁸ Tutje komuna e Ferizajt nuk ka punuar dhe as investuar për kabinete shkencore, kabinete të teknologjisë informative dhe biblioteka, megjithatë mund të konsiderojmë realizimin e premtimit si të filluar.

Premtimi 19. Qendrat për Këshillim në Karrierë për nxënësit që janë në përfundim të shkollës së mesme.

Rezultatet: Nuk ka rezultate në realizim të këtij premtimi, andaj konsiderohet si i pa filluar.

Premtimi 20. Qendra Virtuale e Praktikës Profesionale

Rezultatet: Nuk ka rezultate në realizim të këtij premtimi, andaj konsiderohet si i pa filluar.

Premtimi 21. Inventarizim i shkollave fillore dhe të mesme me mjete përcjellëse për teknologji informative, mjete si tabela dixhitale.

Rezultatet: Tre (3) shkolla të komunës së Ferizajt kanë përfituar një donacion nga OSBE-ja, i cili donacion përfshinë mjete teknologjike si: projektor, llaptop edhe kompjuter. Donacioni është shpërndarë në shkollat “Ahmet Hoxha”, “Vezir Jashari” si dhe shkollën “Tefik Çanga”.²⁹ Tutje edhe pse këto nuk janë investim direkt i komunës, premtimi konsiderohet i filluar duke

²⁷ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://bit.ly/3X7Nm3T>

²⁸ Shih kontratat: i) Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani <https://bit.ly/3Xbhj31> ii) Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani <https://bit.ly/3UMfA2D>. iii) Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj <https://bit.ly/3UMp4KZ>

²⁹ Shih njoftimin nga komuna: <shorturl.at/jsvK8>

pasur parasysh që komuna është interesuar në gjetjen e donatorve të jashtëm për të mbuluar këtë pjesë.

Premtimi 22. Shndërrimi shkollës teknike “Pjetër Bogdani” në Shkollë të Teknologjisë Informative dhe Profesioneve.

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë veprim në kuadër të realizimit të këtij premtimi dhe si i tillë konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 23. Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikimit (TIK) në arsim e që ka për qëllim lidhjen e shkollave fillore dhe të mesme me TIK. Komuna do të ofroj gjithë mbështetjen e saj për këtë projekt. Studimi i Fizibilitetit dhe Analiza kosto-përfitimi financohet me 800 mijë euro nga Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor e BE. Investim total për tërë Kosovën do të jetë 25 milion euro. Me realizimin e këtij projekti në 2023-2024 shkollat tona do të përfitojnë qasje të shpejtë në internet dhe në literaturë, mësim në distancë dhe njohuri për teknologji të reja.

Rezultatet: Nuk ka rezultate në realizimin e këtij premtimi, andaj në këtë këndvështrim mund të konsiderohet ende i pa filluar.

Premtimi 24. Hapja e shkollës së edukatës fizike (Shkolla e sporteve).

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë veprim në kuadër të realizimit të këtij premtimi dhe si i tillë konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 25. Do të ofrojmë hapësirë për ndërtimin e kampusit universitar për universitetin publik.

Rezultatet: Nuk ka pasur kërkesa për ndërtimin e kampusit, andaj si i tillë ky premtim në këtë këndvështrim mund të konsiderohet si i pa filluar.

Premtimi 26. Rritje të vlerës financiare të bursave për profesionet deficitare.

Rezultatet: Kuvendi i Komunës në bazë të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës çdo vit cakton numrin dhe shumën e bursës sipas Rregullores për Ndarje të Bursave për Studentë.³⁰ Nëse krahasohet konkursi i datës 11.11.2020 dhe konkursi i datës 06.12.2021, rezulton që

³⁰ Rregullore 01 Nr.20 për Ndarjen e Bursave për Studentë, datë 11.03.2011 | <https://bit.ly/3EKCOk6>

komuna nuk e ka ndryshuar vlerën, kriteret e as numrin e studentëve përfitues. Komuna gjithashtu ka paraparë “Rritje të shumës së bursave për profesionet deficitare” në shtyllën e pestë (5) Arsim cilësor, fuqizim i bazës teknike, programe dhe profesioniste tek KAB 2023-2025.³¹ Bazuar në të lartëcekurat ky premtim konsiderohet si i pa filluar.

Arsimi				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
17	0	0	6	11

Tabela 2: Arsimi

FUSHA 3. ADMINISTRATË PUBLIKE, FINANCA DHE BUXHETI

Në këtë fushë identifikohen gjithsej katër (4) premtime, njëherit kjo është fushë e cila në mënyrë direkte prek edhe qytatarët. Në vijim do të analizohet se sa është angazhuar për transparencë, shërbime komunale cilësore dhe përfshirjen e grave në leadership gjatë një vjeçarit të parë të mandatit të tij z. Aliu.

Premtimi 27. Transparencë buxhetore, nëpërmjet sistemit të FREE Balancit dhe sistemit të brendshëm të IT-së, shfaqja dixhitale e shpenzimeve buxhetore si dhe të hyrave buxhetore.

Rezultatet: Komuna këtë sistem kishte filluar të aplikoj në vitin 2020 me hapjen e Zyrës për Zhvillim Ekonomik.³² Me vendim të kryetarit, në janar të vitit 2022 është formuar një Grup Punues me pesë (5) anëtar për Hartimin e Planit të Transparencës për periudhën 2022-2026.³³ Ndërkaq, Plani i Veprimit për Transparencë ka për qëllim t’i ofrojë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.³⁴ Ky plan edhe është miratuar nga Kuvendi i Komunës me 31.03.2022.³⁵ Lidhur me këtë shfaqja digjitale e transparencës buxhetore, shpenzimet dhe të hyrat buxhetore përmes

³¹ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://bit.ly/3EJeO0H>

³² Intervista për TV Liria nga Drejtoresha e Drejtorisë së Financave e vitit 2020: <https://www.youtube.com/watch?v=xAXORYPp44U> Shih gjithashtu njoftimin nga komuna të vitit 2020: <https://www.facebook.com/KomunaFerizajt/posts/3122243364488144>

³³ Vendimi për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit të Transparencës, numër 01 Nr.14/22, datë 31.01.2022.

³⁴ Plani i Veprimit për Transparencë 2022-2026, <https://bit.ly/3tDrDmS>

³⁵ Kuvendi i Komunës së Ferizajt, 01.Nr.64, datë 31.03.2022.

televizioneve të cilët shërbejnë për informim brenda institucionit të Komunës së Ferizajt nuk është funksionale në komunë. Andaj në aspektin e realizimit të këtij premtimi mund të thuhet që është filluar.

Premtimi 28: Nuk do të ketë sportele të izoluara nga betoni e xhami por do të ketë hapësirë të hapur ku qytetarët do të marrin shërbime pa pasur barrierë fizike me nëpunësin civil.

Rezultatet: Komuna nuk ka punuar në këtë drejtim, edhe pse në madatin e kaluar ka bërë renovim e objektit të komunës ato ende qëndrojnë të ndara nga betoni e xhami. Andaj si i tillë ky premtim nuk është filluar të punohet.

Premtimi 29. Ofrim i shërbimeve one-stop shop, digjitalizimin i shërbimeve komunale dhe vazhdim i transparencës së shpenzimeve.

Rezultatet: Ofrimi i shërbimeve në modelin “One-Stop Shop” është mundësuar nga gjysma e mandatit të kaluar 2017-2021. Tashmë sistemi për rregullimin e pritjeve dhe ndarjen e sporteleve për qytetarët që dëshirojnë të marrin shërbime publike, nuk është funksionale. Shërbimet digjitale në uebfaqe të komunës si: Fatura e tatimit në pronë, e-administrata nuk janë funksionale. Tutje edhe e-Kiosk që komuna e Ferizajt i posedon nuk janë funksionale. Avansim në këtë fushë ka bërë Platforma e-Kosova e cila u mundësua nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Kosovës. Bazuar në këtë komuna nuk ka punuar mjaftueshëm në përmbushjen e këtij premtimi dhe si i tillë konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 30. Përfshirja e grave në lidhshirë.

Rezultatet: Është punuar në këtë drejtim, konkretisht kemi disa takime, sesione informuese për përfshirjen e grave në agrobiznes, dhe në bashkëpunim me Projekti IWKA është synuar ndarja e granteve për agrobizneset e udhëhequra nga gratë.³⁶ Në këtë këndvështrim, realizimin e këtij premtimi mund t’a konsiderojmë si të filluar.

Administrata Publike, Financat dhe Buxheti				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
4	0	0	2	2

Tabela 3: Administrata Publike, Financat dhe Buxheti

³⁶ Shih njoftimin nga komuna: <https://bit.ly/3EDV7Gr>

FUSHA 4. INFRASTRUKTURA

Në këtë fushë identifikohen gjithsej pesë (5) premtime, gjithashtu edhe kjo është një fushë e cila në mënyrë direkte prek qytetarët e komunës së Ferizajt. Në vijim do të analizohet se sa është angazhuar Komuna e Ferizajt për trotuare funksionale, shirita të gjelbër, rrugë më të mira, furnizim të përmirësuar me ujë, sistem kanalizimi në përputhje me standardet ambientale gjatë një vjeçarit të parë të mandatit 2021-2025 të z. Aliu.

Premtimi 31. Trotuare funksionale në qytet.

Rezultatet: Komuna nuk ka bërë mjaftueshëm për “trotuare funksionale” në qytet, por megjithatë komuna në vitin 2022 ka nënshkruar kontratën “Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaqiku - projekt tre vjeçar”, me vlerë 184.249,35 euro, në këtë rrugë është përfunduar trotuari në segmentin e parë nga rrethrotullimi i nënkalimit deri te qendra Village.³⁷ Lidhur me këtë konstatojmë se komuna ka punuar në këtë drejtim dhe si të tillë INPO e konsideron të filluar.

Premtimi 32. Shirita të gjelbërt në secilën rrugë kryesore në qytet.

Rezultatet: Premtimi përfshinë që në secilën rrugë kryesore në qytet të ketë shiritin e gjelbër për Bëçikleta dhe Trotineta, kurse për rrugët që nuk kanë hapësirë për shirita të ndarë, këta të fundit do të bëhen në të dy skajet e rrugëve. Në këtë drejtim është punuar vetëm në rrugën “Gursel e Bajram Sylejmani” në Ferizaj, me vetëm tre (3) kilometër shtigje të biçiklistëve.³⁸ Kjo është në kuadër të kontratës “Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaqiku - projekt tre vjeçar”. Është e pamjaftueshme duke marrur për bazë nevojat e qytetit të Ferizajt, mirëpo është filluar shiriti i biçikletave dhe shiriti i gjelbërimit në segmentin e parë nga rrethrotullimi i nënkalimit deri te qendra Village. Andaj INPO këtë premtim e konsideron të filluar.

Premtimi 33. Mirëmbajtja, modernizimi dhe zgjerimi i rrugëve për mjetet motorike.

Rezultatet: Për mirëmbajtje të rrugëve, komuna me datë 05.10.2022 ka shpallur njoftimin për kontratë me vlerë 510.000 euro.³⁹ Paraprakisht me Planin e Prokurimit janë ndarë 350.000 euro për “Mirëmbajtje të rrugëve me shenjat e komunikacionit - Vendorsja e shenjave (V LOTO)”.⁴⁰ Komuna

³⁷ Shih kontratën: shorturl.at/elLU2

³⁸ Shih njoftimin nga komuna: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/nje-superlajm-per-ciklistet-ferizajas/>

³⁹ Shih aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve me shenja të trafikut, <https://bit.ly/3hY44SU>

⁴⁰ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

gjithashtu ka investuar edhe në Rregullimi teknik të trafikut dhe sinjalizimit me vlerë 24.945 euro. Gjithashtu është punuar edhe në ndërtim, rregullim dhe asfaltim të rrugëve. 1. Asfaltimi i rrugës dhe trotuari në fsh. Dubravë. 2. Ndërtimi i rrugës Varosh-Gërlicë përgjatë hekurudhës dhe ndërtimi i mbikalimeve për këmbësorë. 3. Punë shtesë Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në fshatin Gaçkë. 4. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balaj-Faza II. 5. Rregullimi i trotuarit, asfaltimi i rrugëve në fshatin Sojevë dhe rrugëve të mbetura në fshatin Zllatar, rregullimi i shtegut dhe trotuarit në rrugën Shaban dhe Rashit Topalli. 6. Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicav të mbetura në fshatin Tërrn dhe Prelez i Jerlive - Faza II - projekt dy vjeçar. 7. Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaqiku - projekt tre vjeçar.⁴¹ Ky premtim është i asaj natyre që nuk mund të përmbushet plotësisht pothuajse asnjëherë, sepse nevoja për mirëmbajtje, zgjerim e modernizim të rrugëve është e përhershme. Andaj do të konsiderohet si premtim gjysmë i përmbushur.

Premtimi 34. Nënkalimi për vetura afër Stacionit të Policisë, gjelbërimi i platosë sipër dhe një amfiteatër afër qendrës multifunksionale.

Rezultatet: Ky projekt është në Planin e Prokurimit si projekt tre vjeçar me vlerë 2.700.000 euro.⁴² Në aktivitetin e prokurimit të inciuar me datë 19.10.2022 dhe i cili ende gjendet në fazën e tenderimit, nuk është paraparë gjelbërimi dhe amfiteatri. Megjithatë, për këtë nënkalim janë ndarë 510.000 euro për fazën e parë.⁴³ Projekti gjendet gjithashtu në Buxhetin e Kosovës për vitin 2022 në kuadër të Financimit të Investimeve Kapitale Komunale dhe me të cilin janë gjithsej si Grant Qeveritar me vlerë 867.849 euro, ndërsa të hyra vetanake me vlerë 1.832,151 euro.⁴⁴ Andaj ky premtim konsiderohet i filluar.

⁴¹ Shih aktivitetet e prokurimit: 1. Asfaltimi i rrugës dhe trotuari në fsh. Dubravë <https://bit.ly/3hTejbo> 2. Ndërtimi i rrugës Varosh-Gërlicë përgjatë hekurudhës dhe ndërtimi i mbikalimeve për këmbësorë <https://bit.ly/3EF8oiZ> 3. Punë shtesë Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në fshatin Gaçkë <https://bit.ly/3EKfVwQ> 4. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balaj-Faza II <https://bit.ly/3UOT5Kk> 5. Rregullimi i trotuarit, asfaltimi i rrugëve në fshatin Sojevë dhe rrugëve të mbetura në fshatin Zllatar, rregullimi i shtegut dhe trotuarit në rrugën Shaban dhe Rashit Topalli <https://bit.ly/3gblWbH> 6. Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicav të mbetura në fshatin Tërrn dhe Prelez i Jerlive-Faza II-projekt dy vjeçar <https://bit.ly/3tLFgAc> 7. Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaqiku-projekt tre vjeçar <https://bit.ly/3giiH3g>

⁴² Planifikimi përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁴³ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësorë afër stacionit policorë në Ferizaj-faza parë <https://bit.ly/3V9Eity>

⁴⁴ LIGJI NR. 08/L-066 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022, Tabela 3.2, faqe 209 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791B0ADE3337.pdf>

Premtimi 35. Furnizimi me ujë të pijes, shtimi i furnizimit me ujë nga burimet nëntokësore dhe përmes sistemit të Ibër-Lepencin ose Penda e Jezercit.

Rezultatet: Penda e Jezercit mendohet që përbën një zgjidhje substanciale dhe afatëgjatë të furnizimit me ujë për Ferizajn dhe komunat përreth, por ende nuk ka rezultate në fillimin të punimeve andaj ky premtim konsiderohet si jo i filluar.

Fusha 4.1. Mbështetja e projekteve nga fusha e infrastrukturës në partneritet me Qeverinë, Bashkimin Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë

Kjo pikë lidhet me projektet nga fusha e infrastrukturës të platformës qeverisëse të z. Aliu për mandatin qeverisëse 2021-2025. Këto janë projektet të cilat për nga buxheti dhe rëndësia mund të jenë shumë më të mëdha, dhe njëherit kërkon edhe angazhim më të madh të komunës për realizimin e tyre dhe bashkëpunimin me partnerët vendor dhe ndërkombëtar. Në këtë pikë janë evidentuar tre (3) premtime.

Premtimi 36. Fabrika për Trajtimin e Ujërave të Zeza.

Rezultatet: Është miratuar Projektligji për ratifikimin e Amendamentit numër 01 të Marrëveshjes të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në lidhje me Programin Kornizë për bashkëpunim financiar, me të cilën Kosovës i mundësohet të marr kredi deri në 62 milion euro e cila do të mundësonte edhe ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj. Bartëse e projektit është Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës.⁴⁵ Për këtë INPO ka kërkuar sqarime nga Komuna e Ferizajt të cilët kanë deklaruar që *“ky projekt ka dështuar për shkak të neglizhencës dhe mos trajtimit me kohë nga Ministria e Financave karshi obligimeve që dalin nga kredia e Qeverisë Hungareze”*. Deri më tani, nuk është bërë ndonjë hap konkret në kuadër të jetësimit të kësaj marrëveshje.

Premtimi 37. Ngrohtorja Qendrore.

⁴⁵ LIGJI NR. 08/L - 024 PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT NR. I TË MARRËVESHJES TË LIDHUR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË HUNGAREZE NË LIDHJE ME PROGRAMIN KORNIZË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=46489> shih gjithashtu prononcimin e Ministrit të Financave z. Hekuran Murati: <https://bit.ly/3V6xk8l>

Rezultatet: Për këtë projekt BE në vitin 2021 ka ndarë një grant në vlerë 2 milion euro në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për studimin e fizibilitetit për futjen e ngrohjes qendrore përmes energjisë së ripërtëritshme në tetë komuna të Kosovës, ku përfitues e këtij granti është edhe Komuna e Ferizajt. Tutje për realizimin e këtij premtimi ende nuk është filluar të punohet nga Komuna e Ferizajt.⁴⁶

Premtimi 38. Ndërlidhja e gazit Maqedoni e Veriut – Kosovë dhe aplikimin e gazit në ngrohje dhe industri në Ferizaj. Po ashtu financim nga BE, do të bëjë studim fizibiliteti të ndërkonjeksionit. Ky projekt financohet me 650.000 euro nga Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor. Projekti është i përkrahur nga EIB dhe EBRD. Tubi i gazit parashikohet të kalojë në afërsi të Ferizajt çka do të mundësojë edhe gazifikimin e qytetit. Nga ky projekt do të përfitohet në aplikimin e gazit në ngrohje dhe industri.

Rezultatet: Nuk ka ende një rezultat për këtë investim dhe si tillë ky premtim konsiderohet si i pa filluar.

Infrastruktura				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
8	0	1	3	4

Tabela 4: Infrastruktura dhe mbështetja e projekteve kapitale të Qeverisë, Bashkimit Evropian dhe donatorëve tjerë

FUSHA 5. SHËNDETËSI

Gjatë fushatës zgjedhore për mandatin qeverisës 2021-2022, z. Aliu kishte premtuar që politikën e tij për shëndetësi janë për shërbime me dinjitet në mbrojtje të shëndetit. Prioritet i fushës së shëndetësisë gjatë fushatës ishte ndërtimi i Spitalit të Ri në Ferizaj, duke vazhduar me investimet në funksionalizim dhe qendra të mjekësisë familjare, bursa në arsim për profilet shëndetësore, vizita mjekësore dhe hapja e zyrës për këshillim për personat që bëhen prindër për herë të parë. Ndër të tjerash kishte premtuar që *“Do të punojmë në shëndetësi preventive përkatësisht sigurimin e një ambienti të sigurtë për shëndetin dhe që nxit një stil të jetës të shëndetshme”*. Në vijim do të të shohim se sa është angazhuar Kryetari i Ferizajt për fushën e shëndetësisë gjatë një viti të mandatit, për t’i realizuar premtimet, të evidentuara nga INPO gjithsej shtatë (7) premtime.

⁴⁶ Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) <https://bit.ly/3U3oKGR>

Premtimi 39. Në mandatin e radhës do të angazhohemi për funksionalizim dhe ndërtim të qendrave të reja të mjekësisë familjare.

Rezultatet: Në Planin e Prokurimit janë planifikuar: “Ndërtimi i QMF-së në Prelez të Muhaxherëve”, “Ndërtimi i QMF-së në Rakaj”, “Ndërtimi i QMF-së në Koshare”, “Ndërtimi i QMF-2”.⁴⁷ Ndërkaq ato edhe pse të planifikuara, deri më tani nuk është inicuar ndonjë aktivitet i prokurimit, e as më pak të realizuara. Lidhur me ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare, komuna në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025 ka paraparë: Ndërtimi i QMF-së 2, Ndërtimi i QMF-së në Prelez të Muhaxherëve, Ndërtimi i QMF-së në Koshare dhe Ndërtimi i QMF-së në Rakaj.⁴⁸ Mbi bazën e të gjeturave nga realizimi i këtij premtimi INPO e konsideron të pa filluar.

Premtimi 40. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) do të ndërroj vend dhe do të vendoset në objekt të ri.

Rezultatet: Kjo qendër fillimisht është planifikuar dhe janë ndarë 20.000 euro me planin e prokurimit.⁴⁹ Projekti është në procedura të tenderimit, konkretisht nga data 05.10.2022 kur është bërë publikimi i njoftimit për kontratë. Ky tender është me vlerë të parashikuar 2.500.000 euro dhe është në bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë.⁵⁰ Bashëfinancues në këtë projekt gjithashtu është edhe shteti i Katarit përmes organizatës "Qatar Charity".⁵¹ Gjithashtu, duke u bazuar në Buxhetin e Kosovës për vitin 2022 në kuadër të Projekteve Kapitale për Nivelin Qendror, janë aprovuar 1.000.000 euro, ndërsa të vlerësuara për vitin 2023 janë gjithsej 1.100.000 euro.⁵² Nga të gjeturat mund të konstatojmë këtë premtim si të filluar.

⁴⁷ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022. “Ndërtimi i QMF-së në Prelez të Muhaxherëve” vlerë 20.000 euro, “Ndërtimi i QMF-së në Rakaj” vlerë 20.000 euro, “Ndërtimi i QMF-së në Koshare” vlerë 30.000 euro, “Ndërtimi i QMF-2” vlerë 30.000 euro.

⁴⁸ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022, faqe 17, <https://bit.ly/3EJ0BRj>

⁴⁹ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

⁵⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj <https://bit.ly/3GnMGkV>

⁵¹ Shih njoftimin nga kryetari i komunës:

[https://www.facebook.com/AgimAliuPDK/posts/pfbid07jPbfBkcXVosW3uA57Y7bzBxzEWkjIzsRxcNTYvDiD5UkPkntWvRNCq9zSpZYiD38I?_cft__\[0\]=AZWLc4HrsMci_dM4ASzIJZfzrn2E96IocjIF4xXylRxZauuH2TnmD0BtmJLT5cxqD7GbslvqyeA5vFxGZBiFLSIRSIsEau0s-](https://www.facebook.com/AgimAliuPDK/posts/pfbid07jPbfBkcXVosW3uA57Y7bzBxzEWkjIzsRxcNTYvDiD5UkPkntWvRNCq9zSpZYiD38I?_cft__[0]=AZWLc4HrsMci_dM4ASzIJZfzrn2E96IocjIF4xXylRxZauuH2TnmD0BtmJLT5cxqD7GbslvqyeA5vFxGZBiFLSIRSIsEau0s-)

⁵² LIGJI NR. 08/L-066 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022, Tabela 3.2, faqe 39 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/IF77FA35-E121-43D3-9683-791B0ADE3337.pdf>.

Premtimi 41. Në programin për bursa në arsim, profilet shëndetësore do të kenë mbështetje të veçantë.

Rezultatet: Në konkursin për bursa të datës 06.12.2021 nuk ka një mbështetje të veçantë për profilet shëndetësore. Nëse krahasohet konkursi i datës 06.12.2021 dhe konkursi i datës 11.11.2020 rezulton se përveç kësaj komuna nuk e ka ndryshuar vlerën, kriteret e as numrin e studentëve përfitues, andaj ky premtim konsiderohet i pa filluar ende.

Premtimi 42. Vizita të rregullta mjekësore.

Rezultatet: Komuna për këtë ka hapur tender me vlerë të parashikuar 1.507.296 euro dhe me të cilën sipas Njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues, OE "Caritas Kosova (C.I.K)". Ferizaj është shpërblyer me kontratë. Me këtë janë paraparë 100.000 vizita mjekësore dhe 9.000 vizita për pacientët në ambulanca, vizita stomatologjike për të moshuar të vetmuar, për nxënës në shkolla, etj. Kjo kontratë është e llojit kornizë dhe ka kohëzgjatje 24 muaj.⁵³ Duke pasur parasysh që Komuna ka nënshkruar kontratë 24 mujore për këto shërbime, INPO vlerëson që ky premtim është gjysmë i përmbushur.

Premtimi 43. Zhvillimi urban në mbështetje të shëndetit.

Rezultatet: Në këtë premtim z. Aliu kishte cituar Organizatën Botërore të Shëndetësisë e cila identifikon urbanizimin si një nga sfidat kryesore të shëndetësisë për shekullin XXI pasi që përderisa qytetet ofrojnë punësim dhe shërbime më të mira mjekësore, gjithnjë është sfidë ofrimi i ambientit fizik dhe shoqëror për të mbështetur shëndetin. Në kuadër të realizimit të këtij premtimi përveç që komuna në vitin 2022 ka nënshkruar kontratat për "Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregulimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara" dhe kontratën "Plani komunal i veprimit për energji dhe klimë", nuk ka rezultate të tjera.⁵⁴ Rrjedhimisht thënë, nuk kemi rezultate të tjera të cilat tregojnë që komuna është duke punuar në zhvillim urban i cili ndikon në mbështetje të shëndetit, megjithatë shofim se zhvillimi urban në Komunën e Ferizajt është në të kundërtën, pra si rezultat kemi ndërtimet e shumëta, djegia

⁵³ Shih aktivitetin e prokurimit: Shërbimet e kujdesit social, shëndetësorë, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF <https://bit.ly/3ghzLX3>

⁵⁴ Shih aktivitetin e prokurimit: Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregulimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara <https://bit.ly/3Enfes0> Shih gjithashtu: Plani komunal i veprimit për energji dhe klimë <https://bit.ly/3Oi9Vyl>

e lëndëve të thëngjillit dhe lëndëve të tjera për ngrohje të cilat shkaktojnë ndotje, veturat e mbeturinat e shumëta të cilat nuk ndikojnë në mbështetje preventive të shëndetit. Përkundër që komuna nuk ka rezultate të mjaftueshme në realizimin e këtij premtimi, me projektin për Krijimin dhe rregullimin e parqeve të reja dhe Plani komunal i veprimit për energji dhe klimë, INPO këtë premtim e konsideron të filluar.

Premtimi 44. Mbështetje financiare dhe të strehimit për familjet në nevojë.

Rezultatet: Komuna ka vazhduar me ndihma emërgjente për familjet me nevojë në dëmet që janë shkaktuar si pasojë e reshjeve të shiut, vërshimeve apo stuhive të fuqishme. Gjithashtu, ka ndarë fonde si ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për familjet me nevojë. Komuna së bashku donatorë të ndryshëm, si nga Shoqata Bamirëse “*Jetimat e Ballkanit*”, organizata joqeveritare “*Tika Kosova*”, etj, ka pasur disa iniciativa për ndihmë me pako ushqimore për familjet me nevojë.⁵⁵ Andaj INPO e konsideron si premtim të filluar.

Premtimi 45. Konsulenca për çiftet, hapja e zyrës për këshillim për personat që bëhen prindër për herë të parë.

Rezultatet: Komuna ende nuk ka arritur të hapë një zyrë në Komunën e Ferizajt për këshillim për çiftet dhe personat që bëhen prindër për herë të parë. Mbi bazën e kësaj ky premtim konsiderohet si i pa filluar.

Shëndetësi				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
7	0	1	3	3

Tabela 5: Shëndetësi

FUSHA 6. URBANIZIMI DHE MBROJTJE MJEDISORE

Politika urbane për mandatin e radhës është mbështetja e rritjes së qytetit si hapësirë dhe popullsi. Kjo sipas z. Aliu, nënkupton infrastrukturë bazë me kapacitete më të mëdha, forcim i standardeve të ndërtimit, modernizim dhe aplikim i metodave të reja të mobilitetit siç janë shtigjet për biçikleta dhe trotinetë. Infrastruktura urbane duhet të kontribuoj në rritje të cilësisë së jetesës, për këtë do të investohet edhe në mjedis që të balancohet ndërtimi. Në kuadër të kësaj fushe janë identifikuar gjashtë (6) premtime, andaj në vijim do të analizohet realizimi i tyre.

⁵⁵ Shih njoftimet nga komuna: <https://bit.ly/3V61o47> dhe <https://bit.ly/3hR9f7i>

Premtimi 46. Tregu i Gjellbërt prej 1.47 hektarë me hapësira të gjellbërta dhe kontenjer nëntokësor.

Rezultatet: Në vitin 2020 komuna kishte hapur konkurs për projektim por komuna nuk ka njoftuar më tutje se çka ka ndodhur me këtë projekt.⁵⁶ Tutje, komuna ka miratuar Projekt-Buxhetin e Komunës së Ferizajt për vitin 2023-2025 dhe rregullimi i tregut është paraparë me 250.000 euro.⁵⁷ Projekti për Rregullimin e Tregut të Gjellbërt, gjendet gjithashtu në KAB 2023-2025. Në bazë të kësaj, INPO konsideron që ende nuk ka filluar zbatimin e këtij premtimi.

Premtimi 47. Bartja e stacionit të autobusëve në hyrje të qytetit.

Rezultatet: Projektin e ndërtimit të stacionit të autobusëve INPO e ka monitoruar që nga inicimi dhe gjatë monitorimit ka vërejtur punë jo cilësore të cilat të gjitha gjetjet janë të përfshira në raportin “Procesi i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës”.⁵⁸ Aktualisht projekti gjendet në fazën e dytë dhe është në procedura të tenderimit, konkretisht kanë aplikuar dy OE, më i liri është shpallur i papërgjegjshëm ndërsa kontrata sipas B08 Njoftimi për Dhënie të Kontratës është 929.154,09 euro me kohëzgjatje për përfundim të kontratës 36 muaj.⁵⁹ Ky projekt është edhe në Projektbuxhetin e komunës 2023-2025 me të cilin për vitin 2023 janë planifikuar 200.000 euro, 2024 janë planifikuar 300.000 euro dhe 2025 janë 382.077,69 euro.⁶⁰ Ndër të tjerash projekti për ndërtimin e stacionit të autobusëve parashihet edhe me Planin e Prokurimit me vetëm 700.000 euro, por pastaj në fazën e tenderimit komuna e ka rritur vlerën për 229.154,09 euro më shumë se sa që e ka planifikuar.⁶¹ Ky projekt gjendet gjithashtu edhe në Listen e Investimeve Kapitale për vitin 2022.⁶² Mbi bazën e kësaj dhe rezultatet nga gjetjet INPO e konsideron këtë premtim si të filluar.

Premtimi 48. Parkingje për biçikleta.

Rezultatet: Nuk ka rezultate të realizimit të këtij premtimi andaj konsiderohet si jo i filluar.

⁵⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: Tregu i gjellbër <https://bit.ly/3ESlny9>

⁵⁷ Projektbuxheti 2023-2025 i datës 31.08.2022 <https://bit.ly/3OgldSQ>

⁵⁸ Shih raportin: Procesi i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave në njëzetë (20) komuna të Republikës së Kosovës, INPO, Prishtinë, prill 2022 <https://bit.ly/3Xbo58X>

⁵⁹ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i stacionit të Autobusëve-faza II <https://bit.ly/3XiwTdk>

⁶⁰ Projektbuxheti 2023-2025 i datës 31.08.2022.

⁶¹ Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit, datë 31.01.2022.

⁶² Lista e Investimeve Kapitale për vitin 2022 <https://bit.ly/3Xix5JA>

Premtimi 49. Parqe të vogla dhe të mesme më shumë drunj.

Rezultatet: Komuna në muajin maj të vitit 2022 ka nënshkruar kontratën për “Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë Dekorativ dhe Rregulimi e mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara” me vlerë 500.000 euro.⁶³ Andaj mund të konstatojmë që komuna ka filluar të punoj në realizim të këtij premtimi.

Premtimi 50. Ndërtim i kolektorëve për ujëra të zeza në secilën lagje dhe fshat.

Rezultatet: Komuna gjatë vitit 2021 dhe 2022 nuk ka punuar mjaftueshëm. Përkundër faktit se komuna i ka përfshirë në Listën e Investimeve Kapitale për vitin 2022 si “Kolektori verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc i Muhaxhereve” dhe “Ndertimi i kolektorit Veri-Perendimor”, ende prej marrjes së mandatit qeverisës 2021-2025 nuk është inicuar ndonjë aktivitet në platformën e-prokurimit për ndërtim të kolektorëve, andaj INPO konsideron këtë premtim si të pa filluar.

Premtimi 51. Ndërtimi i fabrikës për trajtim të ujërave të zeza.

Rezultatet: Ky premtim është në fushën “Mbështetja e projekteve nga fusha e infrastrukturës në partneritet me Qeverinë, BE dhe partnerët ndërkombëtar” konkretisht premtimi tridhjet e gjashtë (36) i cili konsiderohet si i pa filluar.

Urbanizim dhe Mbrojtje Mjedisore				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
6	0	0	2	4

Tabela 6: Urbanizim dhe Mbrojtje Mjedisore

FUSHA 7. KULTURË, RINI DHE SPORT

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit prioritet e z. Aliu ka qenë “Investimi dhe subvencionimi i kulturës dhe sportit, zhvillimi i projekteve për të ofruar hapësirë për shfaqjet kulturore dhe ato të sportit, rikonstruktim, ndërtim dhe funksionalizim të sallave të sporteve”. Në këtë fushë janë evidentuar njëmbëdhjetë (11) premtime.

Premtimi 52. Në rikonstruktim të Parkut “Liria”, do të investohet në ndërtimin e një amfiteatri të hapur i cili do të jetë në shërbim të artistëve.

Rezultatet: Aktualisht gjendet në fazën e hartimit të projektit, me të cilën komuna përmes platformës së prokurimit ka njoftur për Rezultatet e Konkursit të Projektimit i cili është me

⁶³ Shih aktivitetin e prokurimit: Krijimi dhe rregullimi i parqeve të reja, Furnizimi me drunjë dekorativ dhe rregullimi, mirëmbajtja hapsirave të gjelbëruara <https://bit.ly/3GrMa5i>

vlerë të parashikuar 30.000 euro.⁶⁴ Ky premtim konsiderohet i filluar sepse janë marrur masat fillestare të projektimit.

Premtimi 53. Financim të projekteve kulturore.

Rezultatet: Komuna në vitin 2022 ka hapur thirrje për mbështetje financiare publike të OJQ-ve dhe individëve në zbatimin e aktiviteteve kulturore, rinore e sportive në Komunën e Ferizajt me të cilën ka financuar 61 përfitues të projekteve kulturore, rinore dhe sportive. Mbi bazën e kësaj ky premtim konsiderohet i realizuar.

Premtimi 54. Te Kompleksi i Sporteve do të ndërtohet stadiumi i ri i futbollit “*Ismet Shabani*” me kapacitet mbi 10.000 ulëse.

Rezultatet: Për këtë projekt komuna ka mbajtur takim publike me klubet sportive, veteranët e sportit dhe qytetarët për vendin e përzgjedhur për ndërtimin e tij dhe pas konsultimeve është vendosur që stadiumi të ndërtohet tek Palestra e Sporteve “*Bill Clinton*”. Kjo pronë ka qenë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe nuk është lejuar bartja në pronësi të komunës edhe pse kjo e fundit e ka shpallur zonë me interes të përgjithshëm të komunës. Lidhur me këtë është reaguar nga një grup i qytetarëve të cilët kanë dorëzuar në Kuvendin e Komunës së Ferizajt një peticion me të cilin kërkojnë që stadiumi i ri i qytetit të ndërtohet prapa Palestrës së Sporteve “*Bill Clinton*”. Në mbledhjen e tetë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt, është diskutuar ky peticion, ku 29 anëtar të kuvendit votuan pro ndërsa 6 të tjerë abstenuan që Stadiumi i ri të ndërtohet mbrapa Palestrës së Sporteve “*Bill Clinton*”. Lidhur me këtë komuna ka kontaktuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të rifillohen procedurat e reja për ndërtimin e stadiumit, por ministria ka kërkuar që të gjendet një pronë alternative, z. Aliu në takimin publik për vendosjen e hapësirës së stadiumit të ri të qytetit të Ferizajt, kishte potencuar faktin se në hapësirat urbane nuk ka hapësirë tjetër për ndërtimin e stadiumit të qytetit, dhe nëse stadiumin e dërgojmë në ndonjë fshat atëherë si i tillë nuk do të mund të konsiderohet si stadium i qytetit.⁶⁵ Stadiumit i Qytetit ishte i planifikuar me Plan të Prokurimit me një vlerë simbolike me 40.000 euro.⁶⁶ Bartja e pronësisë ende nuk është realizuar edhe pse

⁶⁴ Shih aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projektit-Zgjerimi dhe rregullimi i parkut Liria <https://bit.ly/3OkCag9>

⁶⁵ Plan i Komunës së Ferizajt rreth konsultimeve publike i datës 07.07.2022. <https://bit.ly/3Gs0I4V> dhe procesverbali i datës 07.07.2022 <https://bit.ly/3EkEpyv>

⁶⁶ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

janë ndarë mjetet në Buxhetin e Kosovës për vitin 2022 në kuadër të projekteve kapitale për nivelin qendror, për Stadiumin e Qytetit janë aprovuar 100.000 euro.⁶⁷ Andaj INPO vlerëson që ende nuk është bërë ndonjë hap konkret në kuadër të realizimit të këtij premtimi.

Premtimi 55. Do të ndërtojmë fusha sintetike të futbollit në secilën zonë të qytetit si dhe në shumicën e fshatrave të komunës.

Rezultatet: Përveç që është paraparë me Planin e Prokurimit “Ndërtimi i fushave sportive në qytet dhe fshatra” me vlerë 300.000 euro.⁶⁸ Komuna më pastaj nuk ka marrë ndonjë hap për realizim të këtij premtimi andaj konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 56. Te Kompleksi i Sporteve do të ndërtojmë fusha shtesë të tenisit me qëllim që të mbulohet interesimi.

Rezultatet: Që nga marrja e mandatit nuk ka inicuar ndonjë aktivitet të prokurimit për fusha shtesë të tenisit andaj konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 57. Do të ndërtohen fushat e volejbollit në rërë tek Kompleksi i Fushave Sportive.

Rezultatet: Përveç që është paraparë me Planin e Prokurimit “Ndërtimi i fushës së Beach Volley” me vlerë 30.000 euro, komuna nuk ka ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të realizimit të këtij premtimi, andaj si i tillë konsiderohet i pa filluar.⁶⁹

Premtimi 58. Ndërtimi i një salle për sportet luftarake.

Rezultatet: Edhe pse projekti ka qenë në Plan të Prokurimit për vitin 2022, ende nuk është inicuar për tenderim, më pas projekti “Ndërtimi i një salle për sportet luftarake” është përfshirë në Projektbuxhetin për vitet 2023-2025 i datës 31.08.2022, më të cilin janë ndarë 147.680 euro për vitet 2024-2025.⁷⁰ Ndërkaq ky projekt nuk është inicuar ende andaj konsiderohet i pa filluar.

Premtimi 59. Ndërtimi i sallave sportive për shkolla.

Rezultatet: Megjithëse premtimi është më i gjerë dhe duhet ende shumë punë për përmbushjen e tij, për ndërtimin e sallave sportive për shkolla kemi vetëm një (1) kontratë

⁶⁷ LIGJI NR. 08/L-066 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022, Tabela 3.2, faqe 44 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791B0ADE3337.pdf>.

⁶⁸ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁶⁹ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁷⁰ Projektbuxheti 2023-2025, datë 31.08.2022.

“Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj”. Për këtë aktivitet të prokurimit me vlerë të parashikuar 200.000 euro, kishte ofertuar vetëm një (1) OE me vlerë 296.987,77 euro, pra 96.987,77 euro më shumë se vlera e parashikuar. Megjithatë kjo nuk e pengon komunën dhe me datë 26.05.2022 është nënshkruar kontrata për ndërtimin e kësaj sale.⁷¹ Kjo kontratë ishte planifikuar me Planin e Prokurimit vetëm 50.000 euro.⁷² Më tutje nuk kemi ndonjë sallë tjetër të realizuar andaj konsiderohet se ka filluar përmbushja e këtij premtimi.

Premtimi 60. Financimi i aktivitete kulturore dhe sportive.

Rezultatet: Komuna aktualisht ka një kontratë aktive deri në qershor të vitit 2023 për “Manifestimet Kulturore - në Komunën e Ferizajt”.⁷³ Në Planin e Prokurimit komuna ka paraparë “Mbështetje me material për aktivitete kulturore dhe sportive dhe transport”.⁷⁴ Është punuar në aktivitetet kulturore si: Ditët e Mërgatës, Panair i Librave, Shfaqje teatrore, Festivale etj. Komuna gjithashtu ka mbështetur sportistët dhe klubet duke i siguruar transport brenda dhe jashtë vendit. Mbi bazën e kësaj konsiderojmë si gjysëm të realizuar

Premtimi 61. Funksionalizim i Qendrës Rinore.

Rezultatet: INPO në mungesë të informatave ka kontaktuar Komunën e Ferizajt, në lidhje me këtë kemi përgjigjen se “Është një projekt i papërfunduar që nga viti 2015 kur ka filluar, kemi trashëguar këtë projekt si të papërfunduar në ndërkohë kemi intensifikuar punimet dhe jemi optimist se do të përfundojnë në bazë të afateve kontraktuale, deri në fund të këtij viti”.⁷⁵ Komuna e Ferizajt, aktualisht ka një kontratë aktive për “Mirëmbajtjen e objekteve Kulturore, Sportive dhe Rinore” me vlerë 100.000 euro, e cila skadon në muajin shtator të vitit 2024, kontratë e cila është aktive që nga muaji shtator i vitit 2021 dhe ende nuk ka ndikuar që të funksionalizoj këtë Qendër Rinore.⁷⁶ Në Plan të Prokurimit është paraparë vetëm “Inventarizimi i Qendrës Rinore” e cila jo

⁷¹ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj <https://bit.ly/3geSB0U>

⁷² Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁷³ Shih aktivitetin e prokurimit: Manifestimet Kulturore në Komunën e Ferizajt <https://bit.ly/3XfZY9a>

⁷⁴ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁷⁵ Përgjigja për INPO-n e datës 15.11.2022 nga Komuna e Ferizajt.

⁷⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e objekteve Kulturore, Sportive dhe Rinore <https://bit.ly/3URVKmC>

domosdoshmërishtë nënkupton funksionalizimin, andaj që nga marrja e mandatit nuk është arritur të funksionalizohet dhe ky premtim konsiderohet i pa filluar.⁷⁷

Premtimi 62. Do të mbështeten festivalet kulturore dhe teatrale

Rezultatet: Komuna ka mbështetur festivalet si: Playfest, Festivali i fotografisë Lens Fest, Ferfilm Festival, Bikers Fest, Festivalit Ndërkombëtar të Karikaturës në Ferizaj, Wuman, Mural Fest, Land Festival, Festivali Teatrove etj. Gjithashtu, komuna i ka mbështetur artistët me transport për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Me këtë mund të konstatohet që ky premtim është i realizuar plotësisht.

Kulturë, Rini dhe Sport				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
11	2	1	2	6

Tabela 7: Kulturë, Rini dhe Sport

FUSHA 8. ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

Gajtë fushatës zgjedhore z. Aliu kishte deklaruar që, “Do të punojmë së bashku me bizneset dhe organizatat jo-qeveritare që të përzgjedhim modalitetet më të mira për të përmirësuar ambientin ekonomik”, ndër të tjerash është premtuar subvencionimi i ndërmarrjeve, krijimi i fondit për investim dhe punësim, aftësim për punë dhe trajnime nga komuna, fond i veçantë për gratë në biznes dhe investime në zhvillim të turizmit. Konkretisht trembëdhjetë (13) premtime për të cilat do të analizohet tutje se sa ka punuar në realizimin e tyre.

Premtimi 63. Në katër vitet e ardhshme do të vazhdojmë me subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të rritur kapacitetet e tyre prodhuese, do të punojmë në dizajnimin dhe përgatitjen e parqeve zhvillimore me qëllim që bizneset e reja të kenë një shtysë për të arritur qëndrueshmëri.

Rezultatet: Mund të konstatojmë që ky premtim nuk ka qenë në prioritetet e komunës për vitin 2022 dhe në përmbushjen e këtij premtimi nuk kemi rezultate andaj konsiderohet si premtim i pa filluar.

Premtimi 64. Krijimi i Fondit për Investim dhe Punësim.

⁷⁷ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

Rezultatet: Komuna nuk ka filluar procedurat për krijimin e një fondi të tillë, si rezultat përmbushja e këtij premtimi konsiderohet e pa filluar.

Premtimi 65. Zyra për Zhvillim Ekonomik. Kjo zyrë do të jetë e hapur në aspektin e qasjes së lehtë në të, ajo do të jetë përballë sheshit të qytetit në objektin e Komunës.

Rezultatet: Kjo zyrë është e funksionalizuar në mandatin e kaluar. Lidhur me këtë komuna nuk ka arritur që të transferoj këtë zyrë përball sheshit të qytetit.⁷⁸ Njëkohësisht z. Aliu kishte premtuar që *“Nuk do të ketë sportele të izoluar nga betoni e xhami por do të ketë hapësirë të hapur ku qytetarët do të marrin shërbime pa pasur barrierë fizike me nëpunësin civil”*, kjo nuk ka ndodhur dhe ende ekziston në këtë zyrë barriera nga xhami.⁷⁹ INPO këtë premtim e konsideron të pa filluar.

Premtimi 66. Fondi për Investim dhe Punësim do të zëvendësoj Fondin e Punësimit dhe do të rritet në shumë dhe zgjerohet në aktivitete.

Rezultatet: Që nga marrja e mandatit nuk ka ndonjë iniciativë për realizimin e këtij premtimi, andaj konsiderojm si të pa filluar.

Premtimi 67. Mikrondërmarrjet me të punësuar 1-9 persona do të mbështeten edhe por do të ketë dyfishim të fondit me qëllim të blerjes së makinerive sa më cilësore.

Rezultatet: Nuk ka ndonjë iniciativë për realizimin e këtij premtimi, andaj konsiderojm si të pa filluar.

Premtimi 68. Aftësim për Punë - Mbështetje për trajnime. Komuna do të heq shpenzimet e trajnimit që bëhet brenda në Kosovë.

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë hap më në drejtim të realizimit të këtij premtimi.

Premtimi 69. Mbështetja e Investimeve të Huaja në prodhimtari dhe përpunim, përmes heqjes së kostos së trajnimit të fuqisë punëtore dhe subvencionim të pagave të punëtorëve për 6 muajt e parë.

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë hap më në drejtim të realizimit të këtij premtimi.

⁷⁸ Njoftimi nga komuna i vitit 2020: <https://www.facebook.com/KomunaFerizajt/posts/3122243364488144>

⁷⁹ Shih premtimin numër 28 të këtij raporti.

Premtimi 70. Fondi për biznese të vogla dhe të mesme. Mbështetje për bizneset prodhuese dhe përpunuese të instalojnë energjinë solare duke mbuluar 30% të shpenzimeve.

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë hap më në drejtim të realizimit të këtij premtimi.

Premtimi 71. Fond i Veçantë për Gratë në Biznes me buxhet mbi 100.000 Euro.

Rezultatet: Komuna nuk ka marrë asnjë hap më në drejtim të realizimit të këtij premtimi.

Premtimi 72. Investim në zhvillim të turizmit.

Rezultatet: Me 08.08.2022, përmes dokumentit B52 Njoftimi për nënshkrimin e kontratës komuna ka njoftuar që ka nënshkruar kontratën me titull “*Krijimi i hartave turistike, guidave turistike, librit të bizneseve dhe uebsajdeve të bizneseve, turizmit për Komunen e Ferizajt*” me vlerë 58.200 euro.⁸⁰ Janë vendosur gjithsej katër (4) bilborde, katër (4) city light me hartën turistike, uebfaqja e turizmit www.visit-ferizaj.com, libri i bizneseve dhe uebfaqja e biznesve <http://www.ferizajbusiness.com>, udhezuesi turistik, dhe broshurat turiske në qytetin e Ferizajt. Tutje lidhur me këtë në platformën e prokurimit janë inciuar disa aktivitete por pa dhënë specifika se për cilat vende bëhet fjalë, andaj INPO konsideron këtë premtim si gjysmë të realizuar.

Premtimi 73. Realizimi i projektit “*Ujëmbledhësi i Jezercit*”.

Rezultatet: Ky projekt ende është në fazën e diskutimeve andaj konsiderojmë si ende të pa filluar.

Premtimi 74. Krijimi i shtigjeve malore për biçikleta dhe ecje.

Rezultatet: Komuna përmes uebfaqes ka njoftuar se më 05.10.2022 ka filluar studimi i fizibilitetit për krijimin e rrjetit të shtigjeve turistike në Ferizaj që përfshinë fshatrat: Burrnik, Jezerc, Pleshinë dhe Nerodime.⁸¹ Komuna do të bashkëfinancoj studimin dhe produktet e përshtatshme për zhvillim turistik në këto zona, marrëveshje për rregullimin e shtigjeve të ecjes në rajonet malore dhe hapja e shtigjeve e nënshkruar me organizatën Swiss Contact, në kuadër të projektit FEGO, të financuar nga qeveria suedeze.⁸² Komuna gjithashtu ka mbajtur takime me

⁸⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: Krijimi i hartave turistike, guidave turistike, librit të bizneseve dhe uebsajdeve të bizneseve, turizmit për Komunen e Ferizajt <https://cutt.ly/iMDttXU>

⁸¹ Njoftimi nga komuna: <https://bit.ly/3AujAg2>

⁸² Njoftimi nga kryetari i komunës: <https://bit.ly/3V5SRyb>

shoqata dhe përfaqësues të institucioneve relevante për projektin e shtigjeve të ecjes.⁸³ INPO këtë premtim e konsideron si të filluar.

Premtimi 75. Profilizimi i zonave arkeologjike.

Rezultatet: Komuna ka mbajtur puntori dhe takime konsultative për hartimin e Projekt-Strategjinë e Turizmit të Komunës së Ferizajt për vitin 2023-2027. Më 25.01.2022 është formuar grupi punues me 20 anëtar.⁸⁴ Ndërsa më 31.10.2022 ka miratuar Strategjinë e Turizmit të Komunës së Ferizajt.⁸⁵ Me këtë konsiderojmë që realizimi i këtij premtimi është i filluar.

Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
13	0	1	2	10

Tabela 8: Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

FUSHA 9. SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCA

Shërbimet publike përbëjnë një fushë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve, ani pse e tillë në këtë fushë janë evidentuar vetëm katër (4) premtime dhe prioritetet e z. Aliu për mandatin qeverisës 2021-2025 ishin që “Në mandatin e radhës të angazhohet që mbledhja e mbeturinave të jetë në nivel edhe gjatë verës. Për këtë do të investojmë në makineri të re e cila dyfishon kapacitetet aktuale, krijimi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave i cili do të analizoj dhe ekzekutoj politikat më të mira në menaxhim të sektorit të mbeturinave” dhe se gjatë këtij mandati “Do të angazhohet për gjetjen e investitorëve në përdorim të mbeturinave për riciklim ose prodhim të ngrohjes apo energjisë elektrike”. Për këto premtime tutje do të analizohet sa është shënuar progres në kuadër të realizimit të tyre.

Premtimi 76. Mbledhja e mbeturinave. Do të investojmë në makineri të re e cila dyfishon kapacitetet aktuale.

Rezultatet: Kompania Rajonale për Mbeturina “Pastërtia” në Ferizaj gjatë vitit 2022 ka pranuar 4 automjete për grumbullimin e mbeturinave në Ferizaj, përfituese e Garës për Mjedis të Pastër

⁸³ Njoftimi nga komuna: <https://cutt.ly/oMDta8e>

⁸⁴ Vendimi për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Strategjisë së Turizmit për Komunën e Ferizajt për periudhën 2022-2026, Vendimi numër 01 Nr.12.2022, datë 25.01.2022.

⁸⁵ Raporti nga takimet konsultative për Projekt-Strategjinë e Turizmit të Komunës së Ferizajt për vitin 2023-2027 <https://bit.ly/3tEc8ei>

dhe Grantit të Performancës Komunale në kuadër të bashkëpunimit me MMPHI, MZHE me mbështetjen e GIZ-it gjerman dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW).⁸⁶ Meqë ky investim nuk është i Komunës, INPO konsideron se ende nuk është filluar zbatimi i këtij premtimi.

Premtimi 77. Krijimi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave.

Rezultatet: Kuvendi Komunal ka aprovuar Rregulloren për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Ferizajt. Me këtë rregullore komuna detyrohet të themeloj Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave.⁸⁷ Përkundër faktit se baza juridike është krijuar për themelimin e këtij sektori, i njëjti ende nuk është themeluar. Sidoqoftë, me aprovimin e Rregullores, INPO konsideron se është filluar zbatimi i këtij premtimi.

Premtimi 78. Gjetja e investitorëve në përdorim të mbeturinave për riciklim ose prodhim të ngrohjes apo energjisë elektrike.

Rezultatet: Komuna në dhjetor të vitit 2021 ka nënshkruar kontratën me numër 2021/430-770 me BE si Autoritet Kontraktues, duke qenë udhëheqëse e procesit në partneritet me Komunën e Çairit dhe OJQ “Business Support Center Kosova - (BSCK)” dhe OJQ “Triagolnik”. Projekti “CBCEcoKid” promovon gjenerimin e energjisë së ripërtërishme në institucionet publike. Kohëzgjatja e projektit është 12 muaj. Në lidhje me këtë, komuna më 24.08.2022 ka emëruar komisionin e vlerësimit.⁸⁸ Edhe pse kjo nuk është në mënyrë direkte e lidhur me premtimin në fjalë, INPO përmbushjen e këtij premtimi e konsideron si të filluar.

Premtimi 79. Investime në hidrantë.

Rezultatet: Komuna këtë e ka paraparë me Planin e Prokurimit.⁸⁹ Përmes procedurave të prokurimit ka nënshkruar kontratën për “Ndërtimi i konstruksioneve për vendosjen e hidrantëve” me vlerë 18.257.92 euro.⁹⁰ Vendosja e hidrantëve është bërë në fshatrat Mirosalë, Tërrn, Bibaj, Fshati i Vjetër, Neredime e Ulët, Koshare, në fshatin Gaçkë ne lagjen e Qollakëve, si dhe në

⁸⁶ Shih njoftimin nga komunës: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/kamione-te-rinj-per-krm-pastertia/>

⁸⁷ Rregullore për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Ferizajt, neni 5, data e aprovimit 31.08.2022. Shih gjithashtu vendimin e Kuvendit Komunal: <https://bit.ly/3TSRuBQ>

⁸⁸ Vendimi për emërimin e komisionit të vlerësimit, numër 01-212/22 datë 24.08.2022.

⁸⁹ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁹⁰ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i konstruksioneve për vendosjen e hidrantëve shorturl.at/dFNX0

lagjen e Qiraxhive dhe në rrugën “Uran Tinova” në Ferizaj.⁹¹ Komuna ka arritur që të përmbushë këtë premtim andaj konsiderojmë si të realizuar plotësisht.

Shërbimet Publike dhe Emergjencia				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
4	1	0	2	1

Tabela 9: Shërbimet Publike dhe Emergjencia

FUSHA 10. BUJQËSI DHE PYLLTARI

Fusha e bujqësisë është fusha më prioritare për mandatin qeverisës 2021-2025, kjo argumentohet me faktin se numri i premtimeve në këtë fushë është më i larti krahasuar me fushat e tjera. Pra në këtë fushë janë evidentuar gjithsej njëzetë e katër (24) premtime. Prioritete në këtë fushë janë: Grante për bujqësi dhe blegtori, subvencionim të fermerëve dhe investim në infrastrukturë për mbrojtjen e kulturave bujqësore. Në vijim do të analizohet sa është punuar nga kryetari z. Aliu, për përmbushjen e premtimeve në fushën e bujqësisë dhe pylltarisë.

Premtimi 80. Në katër vitet e ardhshme do të ngrisin shumën e granteve me qëllim të modernizimit të bujqësisë.

Rezultatet: Komuna ka arritur të ngritë vlerën e buxhetit në bujqësi nga 1.666.617,20 euro për dallim prej vitit 2021 ku kanë qenë të ndara 1.065.901,00 euro. Megjithatë premtimi ka qenë që të ngritët shuma e granteve, lidhur me këtë komuna ka arritur që të japë grante për fermerët, por ky është një premtim i gjerë dhe mbetet të shihet edhe në vitet tjera se sa do të arrijë të përmbushë këtë premtim. Tutje ky premtim konsiderohet i filluar në përmbushjen e tij.

Premtimi 81. Katër vitet e ardhshme do të mbështesim bujqësinë dhe blegtorinë me grante.

Rezultatet: Komuna ka mbajtur sesione informuese për fermer dhe agro-biznese, për grante. Gjithashtu Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman në kuadër të projektit IWKA kanë hapur thirrjen për aplikim për grante e cila ka qenë e hapur deri 18.09.2022.⁹² Ky premtim konsiderohet i filluar në përmbushjen e tij gjatë këtij viti të mandatit të z. Aliu.

Premtimi 82. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e serrave gjysëm komerciale dhe familjare.

⁹¹ Njoftimi nga komuna e Ferizajt: <https://bit.ly/3V19GKM>

⁹² Njoftimi nga komuna e Ferizajt: <https://bit.ly/3EdBt3z>

Rezultatet: Komuna në Planin e Prokurimit ka paraparë “Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e serrave” me vlerë 150.000 euro, dhe “Subvencionim të fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje” me vlerë 84.333,21 euro.⁹³ Ndërsa komuna që nga marrja e mandatit të z. Aliu ka nënshkruar dy kontrata “Ndërtimi i Serrës Tunel me Policarbon”, e cila me kontratë parasheh ndërtimin e një (1) serre, gjithashtu kontrata “Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistem të ujitjes pikë-pikë” e cila me kontratë parasheh: Serra të tipit tunel me sipërfaqe 300m² dhjetë (10) copë dhe njëqind e pesëdhjet e pesë (155) serra të tipit tunel me sipërfaqe 50m².⁹⁴ Projekti sipas njoftimit nga komuna është në implementim e sipër, andaj si i tillë konsiderohet si gjysmë i realizuar.⁹⁵

Premtimi 83. Subvencionimi i fermerëve kultivues të kulturave lavërtare me impute bujqësore.

Rezultatet: Komuna me sukses ka arritur që përmes procedurave të tenderimit të bëjë edhe realizimin e premtimit, por megjithatë mbetet të punohet edhe në vitet e ardhshme, gjatë këtij viti komuna ka “Furnizuar fermerët kultivues të grurit me impute bujqësore - pleh artificial azotik” me vlerë 120.000 euro. Nga kjo kontratë janë shpërndarë 125.000 kg pleh azotik.⁹⁶ Me këtë kanë arritur të përfitojnë 414 kultivues të grurit nga Komuna e Ferizajt. Përveç kësaj INPO nuk ka mundur të identifikoj inpute tjera lidhur me këtë premtim dhe për rrjedhojë përmbushja e këtij premtimi vlerësohet si i filluar.

Premtimi 84. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me pemë të imta.

Rezultatet: Komuna ka përkrahur 14 fermerë në ngritjen e pemishteve me mjedra.⁹⁷ Sidoqoftë lidhur me këtë proces komuna nuk ka qenë transparente duke mos publikuar fare shumë e përfituar.⁹⁸ Duke u nisur nga numri i fermerëve dhe lloji i pemëve të imta të furnizuara, INPO vlerëson se ky premtim është i filluar.

⁹³ Planifikimi Përfundimtar i prokurimit, datë 31.01.2022.

⁹⁴ Shih aktivitetin e prokurimit: Ritenderim Ndërtimi i Serrës Tunel me Policarbon <https://bit.ly/3GncsWu> dhe Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistem të ujitjes pikë-pikë <https://bit.ly/3Gp1sl8>

⁹⁵ Njoftimi nga Drejtoria e Bujqësisë: <https://bit.ly/3UOZjtG> dhe njoftimin nga faja zyrtare e komunës: <https://bit.ly/3TMWY11>

⁹⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: Ritenderim-Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore - pleh artificial azotik <https://bit.ly/3XpDnHk> dhe njoftimi nga komuna: <https://cutt.ly/zMS63IK>

⁹⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: Perkraja e fermereve ne ngritjen e pemishteve me mjedra: <https://cutt.ly/JMDqIUF>

⁹⁸ Lista e fermerëve përfitues për mjedra për vitin 2022: <https://cutt.ly/ZMDqWfA>

Premtimi 85. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me pemë të larta.

Rezultatet: Komuna më 03.10.2022 ka hapur thirrjen për aplikim për subvencionimin e fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra e cila përfshinë furnizim me fidane të arrave dhe sistem të ujitjes pikë-pikë.⁹⁹ Ndërkaq komuna ka shpallur rezultatet më 01.11.2022 duke shpallur listën me fermerët përfitues me fidane të arrave dhe sistem të ujitjes pikë-pikë për vitin 2022, me këtë kanë përfituar njëzet (20) fermer nga 0.50h dhe gjithësej kanë arritur të mbillen 10 hektarë.¹⁰⁰ Ndërkohë ky subevencion është rrjedhojë e aktivitetit të prokurimit “Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra” e cila kritike mbetet mospublikimi i dokumentit B52 Njoftimi për nënshkrimin e kontratës dhe komuna nuk ka publikuar fare kontratën me operatorin ekonomik në platformë të Prokurimit.¹⁰¹ Edhe tek përbushja e këtij premtimi vlejnjë argumentet e rezultatev të premtimit 84, dhe zbatimi konsiderohet si i filluar.

Premtimi 86. Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me impute bujqësore.

Rezultatet: Komuna nuk ka arritur të bëjë subvencionimin me impute bujqësore të fermerëve kultivues të perimeve në serra, andaj ky premtim konsiderohet jo i filluar.

Premtimi 87. Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në ambient të hapur bujqësorë.

Rezultatet: Komuna nuk ka arritur të bëjë subvencionimin e fermerëve kultivues të perimeve në ambient të hapur bujqësor, andaj ky premtim konsiderohet jo i filluar.

Premtimi 88. Subvencionimi i fermerve me lopë qumështore.

Rezultatet: Komuna në vitin 2021 kishte inicuar procedurat e tenderimit për furnizim me lopë të racës simental por aktiviteti i prokurimit ishte anuluar. Komuna këtë aktivitet të prokurimit e ka ritenderuar në vitin 2022 dhe me të cilën kanë përfituar 80 fermer. Kontrata ka vlerën 156.000 euro ose 1.950 euro për krerë.¹⁰² Komuna ka realizuar këtë premtim gjatë një vjeçarit të mandatit. INPO këtë premtim e vlerëson si të përmbushur.

Premtimi 89. Subvencionimi i fermerëve me pajisje për bletë.

⁹⁹ Thirrja për aplikim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë e datës 03.10.2022: <https://cutt.ly/KMDqDYD>

¹⁰⁰ Shih njoftimin nga komuna: <https://cutt.ly/YMDqIRf>

¹⁰¹ Shih aktivitetin e prokurimit: Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra <https://cutt.ly/SMDwfQA>

¹⁰² Shih aktivitetin e prokurimit: Ritenderim-Furnizimi i fermerëve me lopë të racës Simental <https://cutt.ly/vMDwzNd>, shih gjithashtu njoftimin nga komuna: <https://cutt.ly/wMDwv3h>

Rezultatet: Komuna ka shpallur procedurat e prokurimi më 16.03.2022 për “Furnizim të fermerëve me koshere të bletëve”.¹⁰³ Lënda ka shkuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me ankesë të operatorit ekonomik “Bletaria Egzoni” i cili ka atakuar dokumentin B05 Njoftimi për kontratë. Ankesa është aprovuar si e bazuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe me të cilën obligon komunën e Ferizajt të anulohet Njoftimi për Kontratë dhe gjithashtu obligon që në dosje të tenderit të eliminoj kriteret kufizuese.¹⁰⁴ Mbi bazën e të lartëcekurave ky premtim konsiderohet jo i filluar.

Premtimi 90. Furnizimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor.

Rezultatet: Komuna që nga marrja e mandatit 2021-2025 nuk ka furnizuar fermerët mjaftueshëm me mekanizëm bujqësor. Komuna më 22.10.2021, përmes dokumentit B52 Njoftim për nënshkrimin e kontratës ka njoftuar për nënshkrimin e kontratës “Punë shtesë-Përkrahja e fermerëve me mekanizim bujqësor”. Në kuadër të kësaj kontrate parashihej furnizimi për fermerë me: Plugj dyrendësh (3) copë, Freza 1.8 m me kardan (8) copë, Spërkatëse 500 litra (3) copë.¹⁰⁵ Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka bërë subvencionimin motokultivatorëve 4.4kw me vlerë 74.880 euro. Gjithashtu, kjo drejtori ka publikuar listën e dyzetë e tetë (48) fermerëve përfitues, edhe në realizim të këtij premtimi shqetësuese mbetet transparenca në sasinë apo vlerën e përfituar për fermerë.¹⁰⁶ Në këtë këndvështrim kemi edhe publikimin e listës së fermerëve përfitues për motokultivatorëve me freza 7.5kw me të cilën kanë përfituar gjithsej dymbëdhjetë (12) fermer.¹⁰⁷ Vlenë të theksohet se komuna ka bërë edhe furnizimin e fermerëve me serra dhe sistem të ujitjes pikë-pikë.¹⁰⁸ Sidoqoftë, duke pasur parasysh që kjo kontratë është punë shtesë e një kontrate të mëhershme, INPO vlerëson që ky premtim është i filluar.

Premtimi 91. Ndërtimi i komorave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve.

¹⁰³ Shih aktivitetin e prokurimit: Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve <https://cutt.ly/aMDwRba>

¹⁰⁴ Shih më shumë lëndën në Organin Shqyrtues të Prokurimit <https://bit.ly/3GoNrtO>

¹⁰⁵ Shih aktivitetin e prokurimit për punë shtesë - Përkrahja e fermerëve me mekanizim bujqësor <https://cutt.ly/zMDwGvY>

¹⁰⁶ Shih aktivitetin e prokurimit: Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje <https://cutt.ly/bMDw2Sq>

¹⁰⁷ Njoftimi nga komuna: <https://cutt.ly/EMDeqNU>

¹⁰⁸ Shih aktivitetet e prokurimit: Ritenderim-Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemi i ujitjes pikë-pikë <https://cutt.ly/9MDeF9U> Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistem të ujitjes pikë-pikë <https://cutt.ly/VMDeTmY>

Rezultatet: Komuna në mandatin e kaluar kishte nënshkruar kontratën për “Rregullimi i dhomave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve”.¹⁰⁹ Lidhur me këtë, që nga marrja e mandatit të ri qeverisës 2021-2025 nuk është iniciuar ndonjë aktivitet i prokurimit, andaj mund të konsiderojmë këtë premtim si të pa filluar.

Premtimi 92. Ndërtimi i bazeneve të sillazhit.

Rezultatet: Komuna për këtë ka nënshkruar kontratën “Ndërtimi i silloseve (baseneve) të sillazhit” me vlerë totale 44.980 euro.¹¹⁰ Nga kjo kontratë kanë përfituar trembëdhjetë (13) fermer.¹¹¹ Duke u nisur nga ajo që janë realizuar vetëm 13 basene të sillazhit, ndërsa kërkesat e fermerëve janë dukshëm më të mëdha, INPO realizimin e këtij premtimi e konsideron si të filluar.

Premtimi 93. Ndërtimi i shtallave gjysëmkomerciale.

Rezultatet: Komuna nuk inicuar procedurat e prokurimit për ndërtimin e shtallave gjysëmkomerciale, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 94. Rregullimi i qendrave për përpunim dhe konzervim të perimeve.

Rezultatet: Komuna nuk ka inicuar procedurat e prokurimit për rregullimin e qendrave për përpunim dhe konzervim të perimeve, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 95. Rregullimi i rrugëve të arave.

Rezultatet: Komuna më 24.03.2022 ka nënshkruar kontratën për rregullimin dhe hapjen e rejat të rrugëve të bujqësisë me titull “Shtuarja e rrugëve me zhavor, hapja e rrugëve të reja, rregullimi i rrugëve të arave LLOT I - Shtuarja e rrugëve me zhavor, hapja e rrugëve të reja LLOT II - Rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr”. Vlera totale e dy loteve është 1.646.274,18 euro.¹¹² Duke u nisur nga ajo që ky projekt është në kohëzgjatje 36 muaj, INPO vlerëson se ky premtim është i filluar.¹¹³

¹⁰⁹ Shih aktivitetin e prokurimit: Rregullimi i dhomave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve <https://cutt.ly/cMDeHDU>

¹⁰⁷ Shih aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i silloseve (baseneve) të sillazhit <https://cutt.ly/aMDe1eF>

¹⁰⁸ Shih gjithashtu njoftimin nga Komuna: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/13-fermere-ferizajas-perfitojne-bazene-te-sillazhit/>

¹¹² Shih aktivitetin e prokurimit: Ritenderim-Shtuarja e rrugëve me zhavor-hapja e rrugëve të reja, rregullimi i rrugëve të arave LLOT I - Shtuarja e rrugëve me zhavor-hapja e rrugëve të reja LLOT II - Rregullimi i rrugëve të arave me zhavor <https://cutt.ly/qMDe45z>

¹¹³ Njoftimi nga Komuna: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/vazhdon-projekti-per-rregullimin-e-rrugeve-te-arave/>

Premtimi 96. Hapja e kanaleve për kullimin e tokave bujqësore.

Rezultatet: Komuna në mandatin e ka kaluar qeverisës, ka nënshkruar kontratën për “Mirëmbajtjen e lumenjve, kanalëve dhe eliminimin i vërshimeve”, me vlerë 75.000 euro e cila është valide deri më 16.08.2023.¹¹⁴ Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 97. Ndërtimi i fermave për pula vojse me kapacitet 500 krerësh.

Rezultatet: Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 98. Furnizimi i fermerëve me rimorkio për transportimin e bletëve.

Rezultatet: Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 99. Infrastrukturë e jashtme e shtallave ekzistuese.

Rezultatet: INPO nuk ka mundur të identifikoj ndonjë projekt tjetër lidhur me infrastrukturën e jashtme të shtallave ekzistuese, përveq bazeneve të sillazhit e cila ndërlihet me premtimin numër 92, andaj si të tillë INPO këtë premtim e konsideron të filluar.

Premtimi 100. Infrastrukture në tharëse të drithërave.

Rezultatet: Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 101. Përkrahja e fermerëve kultivues të bimëve mjekësore dhe aromatike.

Rezultatet: Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

Premtimi 102. Furnizimi i fermerëve me rimorkio.

Rezultatet: Në mandatin e ri nuk ka asnjë kontratë të tillë e cila do të nënkuptonte që komuna ka filluar realizimin e këtij premtimi, andaj ky premtim është jo i filluar.

¹¹⁴ Shih aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e lumenjve, kanalëve-eliminimi i vërshimeve <https://cutt.ly/wMDreT6>

Premtimi 103. Do të mbështesim Agjencionin Pyjor të Kosovës për të rritur sipërfaqet e pyllëzuara.

Rezultatet: Komuna ka filluar me Hartimin e projektit Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve.¹¹⁵ Ky hartim paraqet seriozitetin, angazhimin e komunës për të rritur sipërfaqet e pyllëzuara dhe realizimin e premtimit, andaj ky premtim është i filluar.

Bujqësi dhe Pylltari				
Numri i premtimeve	Të realizuara plotësisht	Gjysmë të realizuara	Të filluara	Të pa filluara
24	1	1	11	11

Tabela 10: Bujqësi dhe Pylltari

Pasqyrë e realizimit të 103 premtimeve

Në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me statusin e premtimeve për secilën fushë veç e veç, dhe në fund pasqyrën totale të përmbushjen e premtimeve të Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

Pasqyrë e realizimit të 103 premtimeve				
Fusha	Premtime të realizuara plotësisht	Premtime gjysmë të realizuara	Premtime të filluara	Premtime të pa filluara
Fusha 1	0	0	3, 4, 5, 7	1, 2, 6, 8, 9
Fusha 2	0	0	10, 12, 14, 16, 18, 21	11, 13, 15, 17, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26
Fusha 3	0	0	27, 30	28, 29
Fusha 4	0	33	31, 32, 34	35, 36, 37, 38
Fusha 5	0	42	40, 43, 44	39, 41, 45
Fusha 6	0	0	47, 49	46, 48, 50, 51
Fusha 7	53, 62	60	52, 59	54, 55, 56, 57, 58, 61
Fusha 8	0	72	74, 75	63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 73
Fusha 9	79	0	77, 78	76
Fusha 10	88	82	80, 81, 83, 84, 85, 90, 92, 95, 97, 99, 103	86, 87, 89, 91, 93, 94, 96, 98, 100, 101, 102
Gjithsej	4	5	37	57

Tabela 11: Pasqyrë e realizimit të 100 premtimeve.

¹¹⁵ Shih aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projektit Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve <https://cutt.ly/DMDri5H>

Projektet kapitale brenda 103 premtimeve

Premtimet e kryetarit të komunës së Ferizajt janë të natyrave, respektivisht të fushave të ndryshme. Për qëllime të raportit në tabelën 12 po i përmendim secilën fushë e cila brenda vetes ka projekte kapitale.

Projektet kapitale brenda 103 premtimeve			
Nr.	Fusha	Projekte kapitale	Të tjera
1	Gjelbrimi	8	1
2	Arsimi	8	9
3	Administratës Publike, Financa dhe Buxheti	0	4
4	Infrastrukturë	7	1
5	Shëndetësi	2	5
6	Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	5	1
7	Kulturë, Rini dhe Sport	7	4
8	Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm	3	10
9	Shërbime Publike dhe Emërgjenca	2	2
10	Bujqësi dhe Pylltari	9	15
Gjithsej	10 fusha	51	52

Tabela 12: Projektet kapitale brenda 103 premtimeve

Nga (103) premtime, janë identifikuar saktësisht se gjysma e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore janë projekte kapitale, pra (52). Në fushën e Gjelbrimit, nga (9) premtime, (8) prej tyre ndërlidhen, respektivisht janë projekte kapitale, ndërsa mund të konsiderojmë që asnjë prej tyre nuk është përmbushur plotësisht. Në fushën e Arsimit nga (17) premtime, vetëm (8) prej tyre janë projekte kapitale, ndërsa asnjë prej tyre nuk është përmbushur plotësisht. Në fushën e Administratës Publike, Financa dhe Buxheti nga (4) premtime, nuk është identifikuar asnjë projekt kapital. Në fushën e Infrastrukturës nga (8) premtime janë identifikuar (7) projekte kapitale dhe asnjë prej tyre nuk është përmbushur plotësisht. Në fushën e Shëndetësisë kemi (7) premtime të cilat (2) nga to janë projekte kapitale. Në fushën Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kemi (6) premtime të cilat (5) prej tyre janë projekte kapitale. Kulturë, Rini dhe Sport, kemi (11) premtime të cilat (7) janë projekte kapitale. Fusha për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm ka (13) premtime të cilat vetëm (3) janë projekte kapitale. Fusha e Shërbimeve Publike dhe Emërgjencave ka (4) premtime, ndërsa (2) janë projekte kapitale. Fusha me më së shumti premtime është ajo e Bujqësisë dhe Pylltarisë me (24) premtime, të cila (9) janë projekte kapitale.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe projektet kapitale të parapara të cilat ndërlidhen me premtimet e kryetarit të komunës

Korniza Afatmesme Buxhetore bënë pjesë në kuadër të dokumenteve kryesore strategjike të komunës, e cila shërben si bazë për hartimin e buxhetit komunal. Hartimi i KAB përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2023/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), dhe në parim, çdo vit duhet të votohet nga kuvendet komunale të komunave. Arsyeja e ekzistimit të KAB-it është për shumë qëllime, mirëpo më i rëndësishmi është vendosja e bazave të planifikimit buxhetor përshatshëmrisht me prioritetet e komunës e cila i ka synim t'i realizojë në të ardhmen. Tutje janë pasqyruar tridhjet (30) projektet kapitale nga pesëdhjetë e një (51) total të premtuara, të cilat janë të përfshira në Investime kapitale të KAB 2023-2025.¹¹⁶

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe projektet kapitale të parapara të cilat ndërlidhen me premtimet e kryetarit të komunës	
1. Zgjerimi dhe rregullimi i Parkut Liria;	16. Ndërtimi i QMF-së 2;
2. Pyllëzimi dhe rregullimi i Parkut në Kodrën e Sherretve;	17. Ndërtimi i QMF-së në Koshare;
3. Ndërtimi i parkut të ish objekti i Pastërtisë;	18. Ndërtimi i QMF-së në Rakaj;
4. Ndërtimi i parqeve të reja, Krijimi i hapësirave të gjelbërta (mbjellja e drunjëve dekorativ);	19. Ndërtimi i Stacionit të ri të Autobusëve në Ferizaj;
5. Ndërtimi i Çerdhes për Fëmijë në Komogllavë;	20. Kolektori verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc i Muhaxhereve deri në Rahovicë;
6. Çerdhja për femijë në Neredime;	21. Ndërtimi i kolektorit Veri-Perendimor, për përfshirjen në kanalizimin e fshatrave;
7. Ndërtimi i çerdhës për Fëmijë në Talinoc të Muhaxherëve;	22. Ndërtimi i kolektorit nga Qiraxhinjët deri në Gërlice;
8. Ndërtimi i sallës së sporteve të shkollës Ganimete Tërbeshi;	23. Stadiumi i qytetit;
9. Ndërtimi i shkollës fillore në fsh.Sazli;	24. Ndërtimi i fushës së Beach Volley;
10. Ndërtimi i shkollës fillore në fsh.Tërrn;	25. Ndërtimi i palestrës për sporte luftarake;
11. Renovimi i shkollës në fsh.Rahovice;	26. Ndërtimi i sallës sportive në Fshatin e Vjetër;
12. Riparimi i rrugëve dhe trotuarëve me asfalt dhe kubëza;	27. Rimodelimi i qendrave informative të turizmit;
13. Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësor afër stacionit policorë në Ferizaj;	28. Hapja e puseve dhe vendosja e hidranteve;
14. Ndërtimi i Ri i QKMF-së me bashkëfinancim me ministrinë;	29. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavor;
15. Ndërtimi i QMF-së në Prelez të Muhaxherëve;	30. Hapja e kanaleve për kullimin e tokave bujqesore;

Tabela 13: Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe projektet kapitale të parapara të cilat ndërlidhen me premtimet e kryetarit të komunës


¹¹⁶ Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025, qershor 2022 <https://cutt.ly/kMDrvhE>

Premtimet për të cilat nevojitet zhvillimi i procedurave të prokurimit

Paraqitja grafike e premtimeve të cilat realizohen përmes procedurave të prokurimit apo të tenderimit është bërë duke marrur për bazë premtimet të cilat për t'u realizuar duhet domosdoshmërisht të kalojnë nëpër procedura të prokurimit. Kjo është e parashikuar me Ligjin Për Prokurimin Publik me të cilën përmes këtyre procedurave sigurohet mënyrë më efikase, më transparente dhe më e drejtë e shfrytëzimit të fondeve publike.

Nga 103 premtime të dhëna gjatë fushatës zgjedhore, vetëm 68 prej tyre për t'u përmbushur duhet të kalojnë nëpër procedura të prokurimit. Ndërsa 35 prej tyre mund të realizohen pa shkuar fare përmes procedurave të prokurimit.

Grafika 3: Paraqitja e premtimeve të cilat realizohen përmes procedurave të prokurimit




Premtimet të cilat kanë qenë të planifikuara me Plan të Prokurimit për vitin 2022

Jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzojë në AQP një planifikim paraprak të prokurimit, me shkrim, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë një viti fiskal.

Nga premtimet të cilat realizohen përmes procedurave të prokurimit, në vijim do të shohim se sa prej tyre kanë qenë të përfshira në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022. Në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022, nga gjithsej gjashtëdhjetë e tetë (68) premtime të cilat duhet të realizohen përmes procedurave të prokurimit, vetëm njëzetë e katër (24) premtime kanë qenë të përfshira plotësisht në planin e prokurimit, tridhjetë e gjashtë (36) nuk kanë qenë të përfshira dhe pjesërisht të përfshira janë tetë (8) premtime.

Grafika 4. Paraqitja e premtimeve të cilat kanë qenë të planifikuara me Plan të Prokurimit vitin 2022




Premtimet e inicuar nëpërmjet procedurave të prokurimit gjatë vitit të parë të mandatit qeverisës

Paraqitja e premtimeve të cilat janë inicuar përmes procedurave të prokurimit nënkupton, iniciimin e premtimeve konkretisht të projekteve përmes platformës e-Prokurimi nga pranimiti i mandatit deri në muajin dhjetor 2022.

Në grafikonin më poshtë janë analizuar premtimet të ndara sipas fushave, të cilat gjithsej janë 10. Secila nga këto fusha përmban në vete premtime, të cilat duhet të realizohen në një formë dhe

duke u analizuar realizimi i premtimeve nga forma e prokurimit kemi gjashtëdhjetë e tetë (68) premtime të cilat për tu përmbushur duhet doemos që të kalojnë në procedura të prokurimit. Nga numri total i premtimeve të cilat për t'u realizuar duhet të kalojnë nëpër procedura të prokurimit janë vetëm njëzetë e shtatë (27) premtime apo projekte të inicuar përmes platformës e-Prokurimi.

Grafika 5. Premtimet e inicuar përmes procedurave të prokurimit



	Fusha 1	Fusha 2	Fusha 3	Fusha 4	Fusha 5	Fusha 6	Fusha 7	Fusha 8	Fusha 9	Fusha 10
■ Gjithsej	5	1	0	2	1	2	2	1	1	12

Rekomandime

- Kryetari i komunës së Ferizajt t'i intensivikojë punët në mënyrë që të realizojë të gjitha premtimet, duke pasur parasysh se numri i premtimeve të realizuara plotësisht është shumë i ulët, edhe pse është përmbushur vetëm një vit i mandatit.
- Të intensivikohen punët lidhur me premtimet që kanë të bëjnë me projekte kapitale sepse nga (103) premtimet, (51) janë projekte kapitale. Përparësi t'u jepet premtimeve të cilat kërkojnë kohë të gjatë të përmbushjes, sepse jo secili premtim mund të realizohet brenda një viti. Në të kundërtën rrezikohet që t'a kalojnë mandatin katër vjeçar.
- Premtimet e filluara, respektivisht gjysmë të përmbushura të vazhdohen punët në mënyrë serioze, në të kundërtën disa prej tyre mund të dështojnë si projekte.
- Sa më parë të fillojnë së zbatuari premtimet të cilat ende nuk kanë filluar.
- Prioritet të kenë premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore, sepse për atë edhe është marrë besimi nga qytetarët.
- Projektet të përfundohen brenda afateve të përcaktuara kohore.
- Kryetari i komunës të koordinoj dhe shpërndaj përgjegjësitë për secilin drejtor komunal, respektivisht t'i vë në përgjegjësi drejtorët e drejtorive në të cilat bëjnë pjesë premtimet e pa përmbushura.
- Komuna në njoftimet e listave për përfitues për grante apo subvencione përveç emrit dhe mbiemrit të përfituesit, të publikoj vlerën apo sasinë e përfituar.
- Qytetarët të mbahen të informuar me ecurinë e projekteve dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me implementimin e tyre.
- Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kuvendin Komunal t'i shikojnë mundësitë se si të tejkalohet problemi i mos ndërprerjes së punëve dhe investimeve kapitale, shkak i të cilit është rritje e çmimeve, përndryshe shumë premtime do të mbesin pa u realizuar, respektivisht nga kjo nuk do të mund të përfitojnë as qytetarët.

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështjet sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: Qeverisja e Mirë dhe Edukimi Demokratik.

inpo-ks.org